

KATALOGU I PRODUKTEVE

Saint-Gobain Construction
Products Albania



Saint-Gobain dizenjon, zhvillon dhe shpërndan zgjidhje novatore që përmirësojnë cilësinë e vendeve ku jetojmë, zvogëlojnë impaktin mjedisor të ndërtesave dhe e bëjnë jetën më të lehtë për klientët e tij profesionistë, të cilët përfshijnë arkitektë, aplikues dhe instalues. Grupi Saint-Gobain ofron një gamë unike të produkteve dhe shërbimeve për të gjitha fushat e industrisë së ndërtimit. Materialet dhe zgjidhjet e Saint-Gobain gjenden kudo në vendet ku jetojmë dhe në jetën tonë të përditshme: ndërtesa, transport, infrastrukturë si dhe në shumë aplikime industriale. Ato ofrojnë rehati, performancë dhe siguri ndërsa i shërbejnë qëllimit të ndërtimit të qëndrueshëm.

[#MakingTheWorldABetterHome](#)



VLERAT TONA FORMOJNË SHTYLLËN KRYESORE TË KULTURËS SË GRUPIT DHE NA UDHËZOJNË ÇDO DITË

5 Parimet e sjelljes

- 1 Angazhim profesional
- 2 Respekti për të tjerët
- 3 Integriteti
- 4 Besnikëria
- 5 Solidariteti

4 Parimet e veprimit

- 1 Respekti për ligjin
- 2 Kujdesi për mjedisin
- 3 Mbrojtja dhe shëndeti punonjësit
- 4 Të drejtat e punonjësve

VLERAT TONA PËRBËJNË BAZËN E QASJES SONË TË PËRGJEGJSHME





**we
care**

Historia e Weber

Kompanitë Weber dhe Broutin u themeluan në Francë në fillim të viteve 1920. Georg Weber dhe Jean-Baptiste Broutin prodhonin suva fasade me bazë gipsi dhe gëlqereje në fabrikën e tyre në Paris. Në vitin 1927, të dy kompanitë u bashkuan në një të vetme. Pas Luftë së Dytë Botërore, kompania u zgjerua në tregun e rindërtimit. Weber & Broutin u bënë pjesë e Grupit Poliet në 1970. Kompania gjithnjë e më shumë përqendrohet në hapjen e tregjeve evropiane. Në 1996, Weber u integrua në Grupin Saint-Gobain dhe operon nën emrin Saint-Gobain Weber. Pas blerjes së specialistëve të suvasë Wülfrather, Montenovo dhe Terranova, Weber hyri në tregun gjerman në 1999. Me marrjen e Grupit maxit në 2008, Weber është zhvilluar në një nga ofruesit kryesorë në Gjermani. Në vitet 2009 - 2012, kompania zgjeron aktivitetin e saj në tregjet e Lindjes së Mesme dhe Azisë. Weber tani është lideri botëror në zgjidhjet me bazë llaçi duke ofruar një gamë të gjerë zgjidhjesh për ndërtesa, konstruksione dhe rinovime.

Natyra jonë e veçantë

Njerëz të
përkushtuar



Njerëzit janë shtytësit kryesor dhe pika kyçe e organizatës së Weber. Nëpërmjet aktiviteteve të tyre të përditshme, njerëzit e Weber tregojnë një përkushtim të madh ndaj qëllimeve të kompanisë, përpiqen për përsosmëri dhe kontribuojnë në performancën dhe zhvillimin e Weber. Sjellja e inovacionit dhe ofrimi i vlerës më të mirë për klientët tanë është i mundur vetëm nëse njerëzit e Weber janë të përkushtuar të dëgjojnë nevojat e klientëve dhe të arrijnë shërbime të jashtëzakonshme.

Njohuri e
përhapur
gjërësisht



Me rreth 10,000 punonjës në më shumë se 64 vende, Weber mund të përdorë një burim shumë të pasur njohurish në mbarë botën. Dëshira dhe aftësia jonë për të dhënë mësim dhe mësuar nga njëri-tjetri në mënyrën më të shpejtë të mundshme na ndihmon të zhvillojmë zgjidhje më të mira dhe më të shpejta për klientët tanë kudo që janë.

Afrimitet



Distribucioni ndërkombëtar i Weber-it plotëson distribucionin e tij lokal në çdo shtet. Zgjidhjet bëhen gjithmonë në nivel lokal, sipas nevojave dhe zakoneve lokale. Prodhimi bëhet në nivel shtetëror apo edhe rajonal, që të jetë pranë klientëve tanë.

Marrëdhënie
afatgjata dhe të
suksesshme me
klientët



Marrëdhënia që ne kërkojmë të ndërtojmë nuk është vetëm një marrëdhënie furnitor-klient. Ne inkurajojmë marrëdhënie më të ngushta dhe besojmë se të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet ia vlen të merren parasysh.

Miqësia dhe
konsiderata



Përveç cilësisë dhe performancës së produktit, ne jemi të përkushtuar të ofrojmë shërbim cilësor për klientët tanë në një marrëdhënie të ngushtë, afatgjatë dhe po aq fitimprurëse. Ne përpiqemi të përmirësojmë kushtet e tyre duke i ndihmuar ata të zhvillojnë njohuritë dhe aktivitetin e tyre.

PËRMBAJTJA

Weber lider në zgjidhjet me bazë suvaje	8
Piktograme Informative	9
Sipërfaqet e Aplikimit	10

SISTEMET E FASADAVE	
Çfarë është Sistemi i Fasadës?	12
Krahasimi i përçueshmërisë termike të njëjtë midis materialeve të ndryshme të ndërtimit	15

PRODUKTET E TERMOIZOLIMIT	
Webertherm Prestige G/W	24
Webertherm Special G/W	25
Webertherm Standard G/W	26
Webertherm Ultra	27
Webertherm Reflect	28
Lesh Guri & XPS	29
EPS & EPS Grafti	30
Webertherm Rrjetë Fasade	31
Webertherm SD-5	32
Aksesorë për Sistemet e Termoizolimit	33
Weberprim S&S	34
Weberprim Akрил	35
Weberprim Beton Kontakt	36
Weberprim Podloga	37
Weberprim Reflect	38
Weberprim Aquabalance	39
Weberprim Steel	40
Webertene Silikonputz	41
Webertene Silikatputz	42
Webertene Extra Clean	43
Webertene Akрилputz	44
Webertene Aquabalance	45
Webertene Reflect	46
Webertene Kulir	47
Webertene Karbokul	48
Webertene Karbokul NOIR	49
Webermin Classic	50
Weberton Akрил	51
Weberton Bet	52
Weberton Pastel	53
Weberton Silikon	54
Weberton ExtraClean	55

SISTEMET E TERMOIZOLIMIT	
Webertherm Premium	18
Webertherm Klima	19
Webertherm Family	20
Webertherm Tradicional	21
Webertherm Protect	22

PRODUKTET E HIDROIZOLIMIT	
Teori Hidroizolimi	58
Weberprim 813	63
Webertec Superflex 10	64
Webertec Aquaseal 2K	65
Webertec Aquastop 2K	66
Webertec D-fix	67
Webertec Smart Protect	68
Webertec D-protect	70
Webertec 828 (Aksesorë)	71

PRODUKTE PËR SHTRIMIN E DYSHEMESË	
Weberniv Razilit	74
Weberniv Razilit Plus	75
Weberfloor Parketofix	76

NGJITËSIT E PLLAKAVE	
Standartet për ngjitësat e pllakave dhe bojakët	80
Webercol EvoFlex G/W	82
Webercol Gress G/W	83
Webercol Smart G/W	84
Webercol Superflex	85
Webercol Crystal Tixogel	86
Webercol Flash Tixogel	87
Webercol Flex Tixogel	88
Webercolor Comfort	89
Weberpox Easy	90
Weberfug Ideal	91
Weberseal Sanitar	92

WEBER POLIURETAN	
Sistem hidroizolimi me poliuretan	96
Detajet e hidroizolimit	97
Produkte poliuretani nga Weber	99

NDËRTIMI DHE KONSOLIDIMI I MURATURAVE	
Si të ndërtojmë dhe konsolidojmë muraturat?	104
Webermur LM10	105
Webermur LM13	106
Webermur blockset LW	107
Webermur Glet	108
Webermur Stuko	109
Webermur Stokryl	110
Webermur Polifix T	111
Webertop Finitura G/W	112

RINOVIMI	
Rinovim + Përforcim i Shtresave të Vjetra	116
Weberprim Deep	117
Weberplan Praktik	118
Weberton Silikat	119
Weberpolicolor Design	120
Weberpolicolor Eko	121
Weberpolicolor Gold	122
Weberpolicolor Latex	123


INOVACIONI	
Fasadë ndriçuese? Bojakë që shndërrin natën	126

WEBER DESIGN	
Weber Design Brick	130
Weber Design Stone	131
Weber Design Wood	132
Weber Design Beton	133



Weber lider në zgjidhjet me bazë suvaje

Si lider botëror në prodhimin e llaçrave industrial, me më shumë se 10.000 të punësuar në 64 vende të botës, Weber ka krijuar kështu një burim të pasur me njohuri nga e gjithë bota. Kjo na jep mundësinë që, duke kombinuar njohuritë e forta lokale dhe eksperiencën ndërkombëtare, të krijojmë më shpejt zgjidhje më të mira dhe të përshtatshme për klientët tanë, kudo që ata të ndodhen.








































 **10.000** punonjës  **64 vende**

 rreth **200 fabrika prodhimi**


Qarkullim vjetor  **më të madh se 2 miliard euro**

Piktograme Informative

					
Jetëgjatësia	Konsumi / m2	Paketim në kovë	Paketim në thes	Paketim në bidon	Paketim në tubetë
					
Paketim në rulon	Paketim në shishe	Duhet të përzihet para aplikimit	Miksim me përzierës elektrik	Përdorim brenda dhe jashtë	Përdorim jashtë
					
Përdorim brenda	Përdorim në dyshe	Përdorim në sistem ETICS	Ekstra fleksibilitet	Koha e pritjes për të aplikuar bojakun	Nuk ka nevojë të shtohet ujë
					
Pesha e paketimit	Paletizimi	Aplikim me pompë ose manual	Përmban fibra përforcuese	Aplikim me mallë	Aplikim me furçë
					
Temperatura e lejuar	Koha e hapur për punë	Aplikim me rul	Ujë i shtuar	Koha e nevojshme që të mund të shkelet	Trashësia maksimale e lejuar e shtresës
					
Për EPS, XPS & GRAFIT EPS	Kushte jo të përshtatshme atmosferike	Për EPS	Për EPS dhe XPS	Për EPS, XPS dhe Lesh Guri	Për të gjitha izolimet



SISTEMET E FASADAVE



Çfarë është Sistemi i Fasadës?

Përkufizimi - funksioni – përbërja

Sistemi i fasadës është një kombinim i materialeve të cilat reciprokisht koordinojnë veprimin e tyre në varësi të izolimit të zgjedhur. Sistemi i certifikuar i fasadës është një kombinim i materialeve të prodhuara, sipas normave dhe standardeve përkatëse të cilat garantojnë zgjidhje të sigurt dhe përmbushin të gjitha kërkesat në përputhje me listën e standarteve dhe rregulloreve që janë paracaktuar për aktivitetin e ndërtimit. Funksioni optimal i sistemit të fasadave është një kusht për dhënien e miratimeve teknike nga institucionet e autorizuar Europiane.

ETICS (External Thermal Insulation Composite System – Sistemi i përbërë i termoizolimit të jashtëm) fasadë, komponentët e së cilës duhet të jenë prodhuar në përputhje me normat dhe standartet e aplikueshme. Të gjithë komponentët duhet të veprojnë për të siguruar një mbrojtje të harmonizuar dhe afatgjatë.



Kur instalohet një sistem fasade, nuk rekomandojmë përdorimin e përzierjeve të cilat janë të përgatitura në vend, si dhe të ngjitësve jo të përshtatshëm (ngjitës për qeramika!) për të zëvendësuar ngjitësat polimere me çimento të ndërtimit. Trashësia e shtresave izoluese dhe atyre të përforcuara, gjithashtu edhe trashësia e shtresës përfundimtare dekorative duhet të jetë brenda normave të përcaktuara nga prodhuesi. Qëllimi i këtyre shtresave nuk është vetëm nivelimi përfundimtar i defekteve të mëdha në të cilën sistemi është inkorporuar. Për shkak të shtresave të paniveluara në materiale formohen hapësira ose spazma, të cilat kthehen në dëm të ndërtimit (të çara, suva që bie, etj...).

Cili është funksioni i sistemit fasadës?

- Mbrojtja termike dhe konsumi i ulët i energjisë
- Nxjerrja e avujve të ujit
- Mbrojtja nga zjarri
- Funksioni estetik

- Parandalimi i urave termike
- Parandalimi i dëmtimit të elementëve ndërtimore nga kondensimi i avujve të ujit
- Shfrytëzimi i aftësisë së mureve për akumulimin e nxehtësisë
- Kontroll i temperaturës së brendshme

Përbërja e sistemit të fasadës

- **Ngjitës fasade për pllakat e izolimit**
- **Pllakat e izolimit**
- **Ngjitës fasade për shtresën e armuar**
- **Rrjetë fasade astar / baza**
- **Shtresa përfundimtare**

Ngjitësi i fasadës siguron aderimin optimal të nënshtresave dhe materialeve izoluese. Shumë shpesh natyra e nënshtresës, tiparet specifike të peshës së objektit dhe shtresa përfundimtare kërkojnë ndërhyrje shtesë për fiksimin mekanik. Vetitë e ngjitësit mund të ndryshojnë në varësi të llojit të pllakave izoluese dhe natyrën e nënshtresës. Me ndihmën e aditivëve të ndryshëm (mbushësat dhe lidhësat) ndryshojnë vetitë e caktuara të ngjitësave.

• Pllakat e izolimit

Detyra kryesore e izolimit është të parandalojë transferimin e nxehtësisë dhe të reduktojë konsumin e energjisë për ngrohje në dimër, si dhe të mbrojë nga i nxehti i jashtëm në verë. Zgjedhja e materialeve izoluese ndikon kryesisht në kushtet e sipërfaqes, pra karakteristikat e saj të veçanta. Kur zgjedhim ndërmjet izolimeve të ofruar të fasadës, përveç izolimit termik është e rëndësishme të merren parasysh kriteret e tjera, të tilla si rezistenca ndaj zjarrit, shpërndarja e përshkueshmërisë, fortësia ndaj presionit, ndjeshmëria ndaj lagështisë etj. Duhet të jemi gjithmonë të vetëdijsëm për rëndësinë e tyre, të mjedisit në të cilin ne marrim sasinë e energjisë të nevojshme për prodhimin e materialeve izoluese dhe mundësinë e riciklimit. Zgjedhja e izolimit të fasadës në kombinim me llojin e nënshtresës janë ato që përcaktojnë llojin e ngjitësit të fasadës dhe grafiaton.

• Ngjitës fasade për shtresën e armuar

Ngjitësat e përdorur janë universalisht të përshtatshëm për ngjitjen e pllakave izoluese dhe përforcimin e shtresës së rrjetës së fasadës. Në disa raste, ngjitësat e përdorur për ngjitjen e pllakave izoluese gjithashtu përdoren për shtresën e armuar. Madhësia e grimcave të rrës dhe aditivëve të ndryshme ndikojnë në vetitë aplikative dhe ngjitëse të caktuara dhe gjithashtu ndikojnë në shpejtësinë e tharjes dhe përshkueshmërisë së avujve të ujit.



• Rrjeta e fasadës

Rrjeta e përforcuar i nënshtrohet tensionit të fasadës nga bymimi dhe tkurrja e saj, si dhe spazmat që rezultojnë në çarje në sipërfaqen e fasadës dhe të grafiatos. Thelbësore është mënyra e aderimit të shtresës alkali-rezistente në ngjitësin e fasadës. Rëndësi të madhe mbart ekzekutimi i duhur dhe shtresat e instalimit në skaje dhe hapje.

• Astari/Baza

Para aplikimit të shtresës përfundimtare rekomandohet përdorimi i astarit/bazës. Astari përdoret për të ngopur dhe zbutur nënshtresën për të arritur absorbim uniform, dhe gjithashtu siguron lidhjen e mirë të nënshtresës me shtresat sipërfaqësore.

• Shtresa përfundimtare

Shtresa përfundimtare, e cila rrethon perimetralisht objektin, përfaqëson pjesën më të ngarkuar të sistemit të fasadës, sepse ajo është e ekspozuar ndaj ndikimeve të vazhdueshme të mjedisit. Detyra kryesore e shtresës përfundimtare është mbrojtja e përhershme nga kushte të pafavorshme të motit dhe parandalimi i penetrimit të lagështisë e cila shkakton dëmtimin e thelbit të sistemit të fasadave dhe strukturave të ndërtimit. Së dyti, dhe kohët e fundit gjithnjë e më e rëndësishme, është estetika që lejon kombinimin e ngjyrës në grafiaton shtresëhollë.

Shtresat përfundimtare janë të varura drejtpërdrejtë nga cilësia e bazës mbi të cilën ato janë aplikuar. Shtresat përfundimtare aplikohet në një nënshtresë duke kombinuar aderimin dhe lidhjet mekanike, që njësohen dhe lëvizin së bashku. Procesi jo i plotë i tharjes në shtresat e përforcuara krijon efektin e tkurrjes në këto të fundit dhe mund të shkaktojë të çara në grafiato.

Shtresat përfundimtare duhet të sigurojnë:


- **Vlerë të ulët w** – absorbimi i lagështisë, duke parandaluar lagështinë e komponentëve të tjerë të sistemit (sipas standardeve ETAG, kjo vlerë duhet të jetë nën 0.5 kg/m^2 në 24h)
- **Vlerë të ulët μ** – depërtueshmëria e avujve, e cila lejon kalimin e avullit të ujit dhe parandalimin e kondensimit nën suva
- **Vlerë të ulët SD** - një pengesë për kalimin e avujve të ujit që ka trashësi të njëjtë me ajrin dhe rezistencë të barabartë.

Llojet e grafiatove

Grafiatot shtresëhollë janë të përbërë nga lloje të ndryshme rëre, grimca zhavori dhe lidhës që përcaktojnë karakteristikat e tyre. Në vija të trasha dallojmë grafiatot akrilike, grafiatot silikate, grafiatot silikone dhe grafiatot minerale. Pas përfundimit me grafiato mund të arrihen strukturat e dëshiruara.




Krahasimi i përçueshmërisë termike të njëjtë midis materialeve të ndryshme të ndërtimit.



Në tabelën e mësipërme paraqiten trashësitë e ndryshme të materialeve për të ofruar të njëjtën performancë termike.

Transferimi i nxehtësisë përcaktohet me $U \text{ (W/m}^2\text{K)}$. Transferimi i nxehtësisë varet nga materiali i instaluar, përçueshmëria e tyre termike dhe trashësia e shtresave të tyre respektive. Rendi i shtresave në parim nuk ndikon në transferimin e nxehtësisë, por bëhet i rëndësishëm kur flitet për akumulimin e nxehtësisë dhe përgjigjen termike të ndërtesave në ndryshimet e kushteve termike në mjedis. Përçueshmëria e ulët termike e strukturës periferike arrihet duke instaluar materiale termoizoluese.

Materialet e ndërtimit kanë karakteristika të ndryshme, të cilat së bashku përcaktojnë efektin e strukturave të ndërtimit si një e tërë. E njëjta gjë vlen për veprimtarinë termike të objektit. Secila pjesë e strukturave të ndërtimit ka përçueshmëri të caktuar të nxehtësisë (vlera U). Nga tabela e mëposhtme është e qartë se cili është konsumi mesatar i energjisë vjetore për 1m^2 mur të jashtëm, i cili është ndërtuar me materiale të ndryshme ndërtimi pa izolim dhe me izolime të ndryshme. Vlera e përçueshmërisë termike $U \text{ (W/m}^2\text{K)}$ shumëzuar me 100 mund të na tregojë në kWh, se sa do të jenë shpenzimet në vit, shumëzuar me 10 dhe sa do të jenë shpenzimet në metra kub, ose sa litra karburant.



Objektet e banimit të paizoluara kanë humbje të mëdha të sasive të energjisë. Shtrirja e fasadës përbën 25-35% të humbjeve të energjisë.





Tabela e vlerave të përçueshmërisë termike

Materialet e ndërtimit	λ	Trashësia e murit	Vlera U pa izolim	Vlera U - EPS - F 040, lesh guri 040								
				4cm	5cm	6cm	8cm	10cm	12cm	15cm	18cm	20cm
Beton	2.04	16	4.3	0.80	0.67	0.57	0.44	0.36	0.31	0.25	0.21	0.19
		20	3.73	0.79	0.66	0.57	0.44	0.36	0.31	0.25	0.21	0.19
Bllok betoni	0.74	19	2.34	0.70	0.60	0.52	0.41	0.34	0.29	0.24	0.20	0.18
		29	1.78	0.64	0.55	0.48	0.39	0.33	0.28	0.23	0.20	0.18
Tullë e plotë	0.68	25	1.86	0.65	0.56	0.49	0.39	0.33	0.28	0.23	0.20	0.18
		38	1.37	0.58	0.51	0.45	0.37	0.31	0.27	0.22	0.19	0.17
Bllok me vrima	0.32	19	1.31	0.57	0.50	0.44	0.36	0.31	0.27	0.22	0.19	0.17
		29	0.93	0.48	0.43	0.39	0.33	0.28	0.25	0.21	0.18	0.16
Bllok termik	0.22	28	0.69	0.41	0.37	0.34	0.29	0.25	0.23	0.19	0.17	0.16
		38	0.53	0.35	0.32	0.29	0.26	0.23	0.20	0.18	0.16	0.14
Beton i lehtësuar	0.14	25	0.51	0.34	0.31	0.29	0.25	0.22	0.20	0.18	0.15	0.14
		40	0.33	0.25	0.23	0.22	0.20	0.18	0.17	0.15	0.13	0.12

Sa më e ulët përçueshmëria termike e materialit, aq më të mira vetitë e tij izoluese. Përçueshmëria termike e materialit $U(\text{W/mK})$ tregon se sa nxehtësi humbet në njësinë e kohës (1 sekondë) për 1m^2 sipërfaqe materiali me trashësi 1m në një ndryshim të temperaturës prej 1K.



Webertherm Premium



Kompozimi i sistemit të fasadës

1. webertherm prestige/W
2. ISOVER Façade Master
3. webertherm prestige/W
4. webertherm rrjetë fasade
5. weberprim S&S
6. webertene Aquabalance/ExtraClean

Sistem termoizolimi me lesh guri



webertherm premium është një sistem termoizolimi me panele prej leshit të gurit 100 kg/m^3 dhe dekoruar me grafiato webertene Aquabalance. Ky sistem është kombinimi i të gjithë përbërësve premium duke përfutur komfortin më të lartë në ambientet e brendshme dhe jetëgjatësinë maksimale të fasadës. **webertherm premium** krijon një klimë të këndshme në ambientet e brendshme, mbron objektin nga humbja e nxehtësisë, kushtet e motit dhe parandalon urat termike, gjithashtu ofron mundësi të pakufizuara zgjedhjeje të ngjyrës së shtresës dekorative. Me instalimin e këtij sistemi, zgjatet jeta e objektit, pasi e gjithë struktura e tij është e mbrojtur nga ndikimet e jashtme. **webertherm premium** është një sistem fasade me kombinimin e duhur të materialeve me cilësi të larta termoizoluese dhe qëndrueshmërie. Ai maksimizon kursimin e energjisë për ngrohjen dhe freskimin e ambienteve të brendshme duke ofruar komfort maksimal jetese dhe qëndrueshmëri të lartë të fasadës dhe pjesëve përbërëse të saj.


Avantazhet

- **sistem me izolim termik premium dhe elasticitet të lartë**
- **rezistencë të lartë mekanike**
- **qëndrueshmëri të lartë të ngjyrave dhe pastërti në fasadë**
- **dalje e shpejtë e avujve të ujit nga brenda-jashtë**

Konsumi i komponentëve:

Përbërja	Produkti	Konsumi	Njësia
Ngjitës/rrafshues për të gjitha llojet e izolimit	webertherm prestige/W	9	kg/m^2
Izolim me lesh guri	Isover Façade Master	1.2	m^2/m^2
Weber Saint-Gobain rrjetë	webertherm rrjetë fasade	1.1	m^2/m^2
Astar	weberprim S&S	0.25	kg/m^2
Grafiato/fasadë dekorative inovative	webertene Aquabalance	2.5-3	kg/m^2

Webertherm Klima



Kompozimi i sistemit të fasadës

1. webertherm special G/W
2. webertherm EPS Graffit
3. webertherm special G/W
4. webertherm rrjetë fasade
5. weberprim S&S
6. webertene ExtraClean

Sistem termoizolimi me EPS Graffit



webertherm Klima është një sistem termoizolimi me panele prej polisteroli të përzier me Grafit për një izolim më të mirë në të njejtën trashësi të aplikuar. Përçueshmëria termike është ulur më shumë nga 0.044 tek EPS I bardhë në 0.036 tek pllakat me grafit për të njëjtën trashësi. Sipërfaqja është dekoruar me grafiato **webertene Extraclean**. Ky sistem është kombinimi i të gjithë përbërësve me cilësi të lartë duke përfutur komfortin optimal në ambientet e brendshme dhe jetëgjatësinë maksimale të fasadës. **webertherm Klima** krijon një klimë të këndshme në ambientet e brendshme, mbron objektin nga humbja e nxehtësisë, kushtet e motit dhe parandalon urat termike, gjithashtu ofron mundësi të pakufizuara zgjedhjeje të ngjyrës së shtresës dekorative. Me instalimin e këtij sistemi, zgjatet jeta e objektit, pasi e gjithë struktura e tij është e mbrojtur nga ndikimet e jashtme. **webertherm Klima** është një sistem fasade me kombinimin optimal të materialeve me cilësi të larta termoizoluese dhe qëndrueshmërie. Ky sistem ul ne maksimum konsumin e energjisë për ngrohjen dhe freskimin e ambienteve të brendshme duke ofruar komfort maksimal jetese dhe qëndrueshmëri të lartë të fasadës dhe pjesëve përbërëse të saj.


Avantazhet

- **Sistem me izolim termik Grafit**
- **Pllaka me përcjellshmëri të ulët termike**
- **Elasticitet i lartë**
- **Rezistencë të lartë mekanike**
- **Qëndrueshmëri të lartë të ngjyrave dhe pastërti në fasadë**
- **Ruajtje optimale e strukturës së ndërtesës pa kosto mirëmbajtje**

Konsumi i komponentëve:

Përbërja	Produkti	Konsumi	Njësia
Ngjitës/rrafshues për të gjitha llojet e izolimit	webertherm Special G/W	9	kg/m^2
Izolim me EPS Graffit	webertherm EPS Graffit	1.2	m^2/m^2
Weber Saint-Gobain rrjetë	webertherm rrjetë fasade	1.1	m^2/m^2
Astar	weberprim S&S	0.25	kg/m^2
Grafiato/fasadë dekorative inovative	webertene Extraclean	2.5-3	kg/m^2

Webertherm Family



Kompozimi i sistemit të fasadës

1. webertherm special/W
2. webertherm EPS
3. webertherm special/W
4. webertherm rrjetë fasade
5. weberprim S&S
6. webertene ExtraClean/Akrilputz

Sistem termoizolimi me polisterol



webertherm family është një sistem termoizolimi me panele termoizoluese prej EPS 18 kg/m³ dhe dekoruar me grafiato/fasadë ExtraClean (me bazë silikat – silikoni). Ky sistem kombinon vetitë më të mira të materialeve dhe kursimin në kostot e mirëmbajtjes. **webertherm family** ofron komfort maksimal në ambientet e brendshme, mbron objektin nga humbja e nxehtësisë, kushtet e motit dhe parandalon urat termike, me përshkueshmëri perfekte të avujve dhe kundërveprim të shkëlqyer me ujin, minimizohen kostot e mirëmbajtjes së sistemit falë vetive vetë-pastruese të grafiato/fasadës. **webertherm family** është një sistem fasade e ideuar për të ofruar komfort maksimal në ambientet e brendshme, me përshkueshmëri perfekte të avujve dhe kundërveprim të shkëlqyer me ujin. Efekti vetë-pastrues i grafiatos zgjat jetën e fasadës dhe ndihmon në kursimin e energjisë për ngrohje dhe ftohje, gjithashtu minimizon kostot e mirëmbajtjes.


Avantazhet

- **sistem termik me elasticitet të lartë**
- **jetëgjatësi më të madhe të fasadës**
- **rezistencë të lartë të ngjyrave**
- **i përshtatshëm për klimë bregdetare**

Konsumi i komponentëve:

Përbërja	Produkti	Konsumi	Njësia
Ngjitës për EPS dhe XPS	webertherm special/W	11	kg/m ²
Izolim me pllaka polisteroli	webertherm EPS	1,2	m ² /m ²
Saint-Gobain Adforce	webertherm rrjetë fasade	1,1	m ² /m ²
Astar	weberprim S&S	0,25	kg/m ²
Grafiato/fasadë dekorative vetë-pastruese	webertene ExtraClean	2,5-3	kg/m ²

Webertherm Traditional



Kompozimi i sistemit të fasadës

1. webertherm special/W
2. ISOVER Façade Master
3. webertherm special/W
4. webertherm rrjetë fasade
5. weberprim akril
6. webermin classic
7. weberprim podloga IN
8. weberton akril

Sistem termoizolimi me polisterol




webertherm traditional është një sistem termoizolimi me panele EPS 15 kg/m³, i dekoruar me grafiato/fasadë minerale dhe i ngjyrosur me bojë akrilike. **webertherm traditional** krijon një klimë të këndshme në ambientet e brendshme, mbron objektin nga humbja e nxehtësisë, kushtet e motit dhe parandalon urat termike, gjithashtu ofron mundësi të pakufizuara zgjedhjeje të ngjyrës së shtresës dekorative. Me instalimin e këtij sistemi, zgjatet jeta e objektit, pasi e gjithë struktura e tij është e mbrojtur nga ndikimet e jashtme. **webertherm traditional** është një sistem fasade ekonomik, i cili ndihmon në kursimin e energjisë për ngrohjen dhe ftohjen e ambienteve të brendshme sepse akumulon ngrohtësinë, ruan temperaturën konstante të dhomës dhe parandalon ndryshimet drastike të temperaturës.

Avantazhet

- **sistem termik me elasticitet të lartë**
- **kombinim i mirë i raportit cilësi/çmim**
- **numër i pakufizuar ngjyrash**
- **rezistencë të lartë dhe kundërveprim i mirë me ujin**

Konsumi i komponentëve:

Përbërja	Produkti	Konsumi	Njësia
Ngjitës/rrafshues për EPS dhe XPS	webertherm special/W	11	kg/m ²
Pllaka lesh guri për sisteme termoizolimi	Isover Façade Master	1,2	m ² /m ²
Weber Saint-Gobain rrjetë	webertherm rrjetë fasade	1,1	m ² /m ²
Astar	weberprim akril	0,25	kg/m ²
Grafiato dekorative minerale	webermin classic	2,7	kg/m ²
Astar	weberprim podloga IN	0,3	kg/m ²
Bojë fasade me bazë silikate	weberton akril	0,4	kg/m ²



Kompozimi i sistemit të fasadës

- 1. webertherm Prestige G/W
- 2. webertherm XPS
- 3. webertherm Prestige G/W
- 4. webertherm rrjetë fasade
- 5. weberprim akril
- 6. webertene Kulir/Karbokul



Sistem termoizolimi me xokol me XPS

webertherm Protect është një sistem termoizolimi me panele prej XPS (polistiren) me aftësi të larta rezistence mekanike. Ky sistem është perfekt për mbrojtjen, izolimin, dekorimin dhe mënjanimin e urave termike që vijnë nga sipërfaqet e betonit të themelit. Për shkak të ngarkesave më të larta që rezultojnë nga kontakti i drejtpërdrejtë i themelit me bazën, ky sistem është i përshtatshëm për nivelin O/O dhe -1 ose më poshtë, si mbrojtës i sigurtë hidroizolimit. Sipërfaqja mbi nivelin e tokës dekorohet me suvanë me gurë shumëngjyrësh **webertene Kulir/Karbokul**. Ky sistem është një kombinim i të gjithë përbërësve me cilësi të lartë që janë reciprokisht të pajtueshme për sa i përket vetive fizike. **webertherm Protect** gjithashtu, ofron mundësi të pakufizuara zgjedhjeje të ngjyrës së shtresës dekorative. Dekori prej gurësh shumëngjyrësh ka një efekt rezistent ndaj lagështirës dhe kombinohet perfekt me elementët e natyrës që e rrethon dhe ka një gamë të lartë kombinimesh. Me instalimin e këtij sistemi, zgjatet jeta e objektit, pasi e gjithë struktura e tij është e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm dhe gërryes të tokës.

Avantazhet

- 2në1 - Sistem me izolim termik dhe mbrojtës
- Pllaka me përcjellshmëri të ulët termike 0.030
- Rezistencë të lartë mekanike
- Gamë e gjerë kombinimesh të gurëve shumëngjyrësh
- Përshtatje e ngjyrave me natyrën
- Ruajtje optimale e strukturës së ndërtesës pa kosto mirëmbajtje


Konsumi i komponentëve:

Përbërja	Produkti	Konsumi	Njësia
Ngjitës/rrafshues për të gjitha lloje e izolimit	webertherm Prestige G/W	9	kg/m ²
Izolim me XPS	Isover XPS	1.2	m ² /m ²
Weber Saint-Gobain rrjetë	webertherm rrjetë fasade	1.1	m ² /m ²
Astar	Weberprim akril	0.25	kg/m ²
Grafiato/fasadë dekorative inovative	webertene kulir/karbokul	2.5-3	kg/m ²



PRODUKTET E TERMOIZOLIMIT

Webertherm Prestige G/W



Paketimi:	25Kg
Çertifikatat:	EN 998-1
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Ngjitës dhe rrafshues i thatë me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griPër të gjitha llojet e paneleve izoluese dhe nënshtresave

Përshkrimi

Webertherm prestige është ngjitës dhe rrafshues i thatë i cilësisë së lartë, me bazë çimento, mbushës dhe aditivë cilësorë, dhe i pasuruar me polimere të përshtatshme. Përdoret për ngjitjen dhe rrafshimin e rrjetës së armimit dhe të gjitha pllakave termoizoluese si EPS, XPS, leshguri, tapë etj; në të gjithë llojet e bazamenteve të çimentos e deri tek ato më kritike (tullë, dru, metal, qelq, etj). Përdoret në të gjitha llojet e sistemeve të izolimit termik. Webertherm Prestige nuk është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare.

Përgatitja e bazamentit

Bazamenti ku do të aplikohen panelet e izolimit termik duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, i pastër dhe pa prani pluhuri apo mikroorganizmash. Problemet e mundshme të bazamentit, duhet të riparohen para fillimit të punimeve. Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të rënda të motit. Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri/Bardhë
Kokërrzimi	0.8mm
Konsumi	8-10 kg/m²
Konsumi (në ngjitje)	6-7 kg/m²
Konsumi (në arnim)	2-3 kg/m²
Konsumi i ujit	6,5 – 7 L
Trashësia min. e shtresës	3 mm

Udhëzime mbi aplikimin

Përmbajtja prej 25kg e thesit përzihet me mikser elektrik duke i shtuar gradualisht 6,5-7 l ujë sipas nevojës. Pas përzjerjes së parë, masa lihet në prehje për rreth 10 min dhe më pas përziejhet përsëri para se të aplikohet, masa e përgatitur duhet të përdoret brenda 3 orëve. Nëse ngjitësi do të aplikohet në pllakat termoizoluese të EPS, XPS apo materiale izoluese relativisht të lehta, duhet të aplikohet prapa, në kornizë dhe 3 masa të bollshme në mes të pllakave izoluese. Nëse ngjitësi do të përdoret për izolim termik me pllaka të leshit të gurit, duhet të aplikohet në të gjithë sipërfaqen e pllakës me mallë të dhëmbëzuar 10x10 në rastin e sipërfaqeve të rrafshuara. Instalimi i upave dhe i rrjetës së armimit është i mundur 2 ditë pas ngjitjes së pllakave izoluese. Sipërfaqja e paneleve izoluese rrafshohet me ngjitës në një shtresë me trashësi 2-4 mm në të cilën shtrohet rrjeta, në 1/3 e trashësisë së shtresës së ngjitësit, rrafshimi i rrjetës duhet bërë pasi shtresa paraardhëse të jetë tharë plotësisht. Shtresa përfundimtare dekoruese duhet të aplikohet të paktën 7 ditë nga aplikimi i shtresës së fundit të ngjitësit. Për ndërtesa me lartësi më të madhe se 3m, këshillohet përdorimi i upave të fasadës për fiksimin e paneleve në bazament, këshillohen 6 upa / m². Ngjiteshi nuk këshillohet të përdoret për mbushjen e hapësirave të mbetura midis pllakave të izolimit termik – duhet të mbushen me material izolues.

Treguesit fiziko-mekanikë

Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	1.3 - 1.4 Gr/m³
Mbjetje 180 µ	50-60%
Uje-mbajtja	99%
Masa vëllimore e llaçit në 20°C	1600-1700 kg/l
Gjendja	Pluhur

Treguesit kimikë

Lagështira	0.10%
Aditivë	2%

Webertherm Special G/W



Paketimi:	25Kg
Çertifikatat:	EN 998-1
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Ngjitës dhe rrafshues i thatë me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griKokërrzimi 0.6mm

Përshkrimi

Webertherm special është ngjitës dhe rrafshues i thatë, me bazë çimento, mbushës cilësorë dhe aditivë të përshtatshëm. Përdoret për ngjitjen dhe rrafshimin e paneleve izoluese të EPS dhe XPS. Njëkohësisht përdoret edhe për rrafshimin e sipërfaqes së tyre për të krijuar shtresën e armuar ku aplikohet rrjeta e fasadës. Webertherm Special nuk është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare.

Përgatitja e bazamentit

Bazamenti ku do të aplikohen panelet e izolimit termik duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, i pastër dhe pa prani pluhuri apo mikroorganizmash. Problemet e mundshme të bazamentit, duhet të riparohen para fillimit të punimeve. Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të papërshtatshme të motit. Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri/Bardhë
Kokërrzimi	0.7mm
Konsumi	8-10 kg/m²
Konsumi (në ngjitje)	6-7 kg/m²
Konsumi (në arnim)	2-3 kg/m²
Konsumi i ujit	6,5 – 7 L
Trashësia min. e shtresës	3 mm

Udhëzime mbi aplikimin

Përmbajtja prej 25kg e thesit përzihet me mikser elektrik duke i shtuar gradualisht 6,5-7 l ujë sipas nevojës. Pas përzjerjes së parë, masa lihet në prehje për rreth 10 min dhe më pas përziejhet përsëri para se të aplikohet. Përzjerja e përgatitur aplikohet në pjesën e pasme të paneleve izoluese të EPS apo XPS me anë të mallës, në formë shiriti në anë dhe tre pika të bollshme në mes të pllakës. Për ndërtesa me lartësi më të madhe se 3m, këshillohet përdorimi i upave të fasadës për fiksimin e paneleve në bazament, këshillohen 6 upa / m². Sipërfaqja e paneleve izoluese rrafshohet me ngjitës në një shtresë me trashësi 2-4 mm në të cilën shtrohet rrjeta, në 1/3 e trashësisë së shtresës së sipërme të ngjitësit. Shtresa përfundimtare dekorative mund të aplikohet 7 ditë pas aplikimit të shtresës së fundit të ngjitësit. Masa e përgatitur duhet të konsumohet brenda jo më shumë se 6 orësh nga përgatitja.

Treguesit fiziko-mekanikë

Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	1.3 - 1.4 Gr/m³
Mbjetje 180 µ	53%
Uje-mbajtja	99%
Masa vëllimore e llaçit në 20°C	1600-1700 kg/l
Gjendja	Pluhur

Treguesit kimikë

Lagështira	0.10%
Aditivë	1.5%

Webertherm Standard G/W



Paketimi:	25Kg
Çertifikatat:	EN 998-1
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Ngjitës dhe rrafshues i thatë me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griKokërrzimi 0.6mm

Përshkrimi

Webertherm Standard është ngjitës i thatë, me bazë çimento, mbushës cilësorë dhe aditivë të përshtatshëm. Webertherm Standard është shumë i fortë në ngjitje, i lehtë për tu aplikuar dhe i kokrrizuar. Përdoret vetëm për ngjitjen e polisterolit. Webertherm Standard nuk është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare.



Përdorimi

Bazamenti ku do të aplikohen panelet e izolimit termik duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, i pastër dhe pa prani pluhuri apo mikroorganizmash. Problemet e mundshme të bazamentit, duhet të riparohen para fillimit të punimeve. Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të parpershtatshme të motit. Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri/Bardhë
Kokërrzimi	0.6mm
Konsumi (në ngjitje)	6-7 kg/m²
Konsumi (në arnim)	2-3 kg/m²
Konsumi i ujit	6,5 - 7 L
Trashësia min. e shtresës	5 mm

Udhëzime mbi aplikimin

Përmbajtja prej 25kg e thesit përzihet me mikser elektrik duke i shtuar gradualisht 6,5-7 l ujë sipas nevojës. Pas përzjerjes së parë, masa lihet në prehje për rreth 10 min dhe më pas përzjehet përsëri para se të aplikohet. Përzjerja e përgatitur aplikohet në pjesën e pasme të paneleve izoluese të EPS anë të mallës, në formë shiriti në anë dhe tre pika të bollshme në mes të pllakës. Për ndërtesa me lartësi më të madhe se 3m, këshillohet përdorimi i upave të fasadës për fiksimin e paneleve në bazament, këshillohen 6 upa / m². Masa e përgatitur duhet të konsumohet brenda jo më shumë se 6 orësh nga përgatitja.

Webertherm Ultra



Paketimi:	25Kg
Çertifikatat:	EN 998-1
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Ngjitës dhe rrafshues i thatë me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griKokërrzimi 0.6mm

Përshkrimi

webertherm ultra është ngjitës i lehtësuar, me konsum të reduktuar deri në 30% në krahasim me ngjitësat e tjerë të zakonshëm. Ka në përbërje çimento dhe karbonat kalciumi dhe është i pasuruar me agregate të lehta për të rritur volumin dhe punueshmërinë.

Përdorimi

I përshtatshëm për ngjitjen e të gjitha llojeve të polisterolit, grafit polisterolit dhe XPS në sistemin e termoizolimit webertherm premium. Përdoret në sistem për ngjitjen dhe rrafshimin e izolimit termik.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	17kg/thes
Ngjyra	Gri
Kokërrzimi	E imët
Konsumi (në ngjitje)	6.3 kg/m²
Trashësia e shtresës	3-5 mm

Aplikimi

Sipërfaqja duhet të jetë e sheshtë, e pastër, e qëndrueshme, e thatë dhe pa pjesë që mund të shpëputen. Të gjitha pabarazitë dhe dëmtimet duhen korrigjuar përpara fillimit të punës. Sipërfaqet shumë poroze është e nevojshme të trajtohen me weberprim podloga IN të paktën 6 deri 12 orë para aplikimit të ngjitësit. Thesin me 17 kg e shtojmë në 6L ujë, ngadalë dhe duke e përzier vazhdimisht që të mos krijohen kokrriza. Prisni 10 minuta dhe pastaj përzieni përsëri për të arritur një masë homogjene me punueshmeri të lartë. Ngjitësi aplikohet në formë shiriti përgjatë skajeve dhe një sasi e bollshme në mes të pllakës izoluese. Pas të paktën 2 ditësh, kur shtresa e ngjitësit është plotësisht e ngurtë, mund të aplikohen upat dhe më pas shtresa e armuar në trashësi 3 deri 5mm ngjitësi të njomë, në mënyrë që e gjithë sipërfaqja e rrjetës të mbulohet me ngjitës. Kur kjo shtresë është plotësisht e thatë, aplikoni një shtresë të tretë, rrafshimi/nivelimi. Nëse mbi sipërfaqen e ngjitësit krijohet kore, këshillohet që ajo të eliminohet dhe të aplikohet një shtresë e re. Shtresa përfundimtare dekorative duhet aplikuar pas të paktën 7 ditësh nga aplikimi i shtresës së fundit të ngjitësit. Shtresa dekorative duhet të aplikohet jo më parë se 7 ditë pasi është aplikuar ngjitësi.

Performanca

Reagimi ndaj zjarrit	Klasa F
Absorbimi i ujit	0.105 Kg/(m²*min 1/2)
Përshkueshmëria e avullit të ujit	≤15 μ
Fortësia në ngjitje	CSII MPa
Ngjitja pas ekspozimit ndaj kushteve atmosferike	≥0.5 MPa

Webertherm Reflect



Ngjitës jashtëzakonisht fleksibël për të gjitha llojet e pllakave termoizoluese



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Jashtëzakonisht elastikMe bazë çimentoje dhe lidhësa polimeriPërshkueshmëri e avujve

Përshkrimi

Webertherm Reflect përdoret kryesisht në sistemin e fasadës Webertherm Reflect, së bashku me llaçin e fasadës Webertene Reflect, duke siguruar një shtresë të qëndrueshme dhe elastike nën llaçin përfundimtar, i cili është rezistent ndaj lëvizjeve të shkaktuara nga temperaturat e larta në sipërfaqen e fasadave të errëta, si dhe nga ftohja e papritur. Webertherm Reflect është i bërë në bazë të çimentos së bardhë dhe lidhësve polimer, me përforcues shtesë, gjë që e bën atë shumë të fortë, dhe në të njëjtën kohë jashtëzakonisht elastik, të përshkueshëm nga avulli dhe me ngjitje të lartë për të gjitha llojet e pllakave të izolimit termik.

Përgatitja e nënshtresës

Sipërfaqja në të cilën aplikohet produkti duhet të jetë e sheshtë, e pastër, e fortë, e thatë, pa yndyrë dhe pa pjesë të dobëta. Riparoni të gjitha vendet jo të rrafshuara dhe dëmtimet përpara fillimit të punës. Mbetjet e bojës së vjetër, gëlqeres dhe papastërtive ekzistuese duhet të hiqen plotësisht paraprakisht. Kontrolloni rrafshimin e sipërfaqes me një fill të gjatë, devijimi max. 1 cm në një gjatësi prej 3 m. Nivelimi i mëparshëm të bëhet me llaç çimentoje, asnjëherë me materialin ngjitës! Nëse nënshtresa është e ekspozuar ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohet dëmtimi i shkaktuar nga shfaqja e lagështirës ose të vendoset një shtresë izoluese që do të parandalojë ardhjen e drejtpërdrejtë të lagështirës në shtresën

mbi të cilën do të aplikohet webertherm Reflect. Nënshtresat që janë shumë absorbuese dhe të vjetra duhet të lyhen me weberprim deep, 2 deri në 4 orë para fillimit të punës, në varësi të temperaturës. Për sipërfaqet e suvatuara më përpara, kontrolloni ngjitjen e vetë llaçit. Nëse nuk është ngjitur mirë, duhet të mbulohet dhe perforohet me llaç çimentoje. Përfundoni shtresën dekorative të suvasë së fasadës ose bojës së fasadës, aplikoni pas të paktën 7 ditësh nga aplikimi i shtresës së fundit të ngjitësit mbi pllakat termoizoluese apo nënshtresa të tjera.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Bardhë
Konsumi i ujit	7.5l

Aplikimi

Thesi i Webertherm Reflect prej 25 kg përzihet me 7,5 litra ujë të pastër me një mikser elektrik me shpejtësi të ulët deri në homogjenizimin e plotë. Lëreni masën të qëndrojë për 10 minuta, më pas përzieni përsëri me një mikser elektrik derisa të zhduken kokrrat e papërziera mirë. Weber rekomandon që të bëhen prova më të vogla në sipërfaqe përpara fillimit të punës për të kontrolluar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e produktit. Nëse vëreni ndonjë devijim nga cilësia kur bëni sipërfaqen e provës, ju lutemi ndaloni punën dhe kontaktoni një përfaqësues të Weber.

Lidhja e pllakave termoizoluese

Gjatë ngjitjes së pllakave termoizoluese, masa e përgatitur aplikohet me një mistri në pjesën e pasme të pllakës termoizoluese, me vija përgjatë buzës së të gjithë kornizës së pllakës, me ngjitës të shtuar në 3 ose 6 vende në mes të pllakave izoluese. Produkti webertherm Reflect duhet të mbulojë një minimum prej 40% të sipërfaqes në pjesën e pasme të pllakës. Nëse nënshtresa është idealisht e sheshtë, ngjitësi mund të aplikohet në të gjithë pjesën e pasme, d.m.th. pllaka me mistri të dhëmbëzuar (gjerësia dhe thellësia e dhëmbëve nga 8 deri në 10 mm) Ngjitini pllakat termoizoluese afër njëra-tjetrës në mënyrë që ngjitësi të mos dalë nga sipërfaqja e kontaktit. Sigurohuni që pllakat të jenë ngjitur drejt dhe kontrolloni gjithçka me një fill nivelimi. Në qoshet e ndërtesës zbatohen rregullat për lidhjen e muraturës (lidhje tërthore). Prisni pjesën e tepërt në qoshe min. 2 ditë pas ngjitjes së pllakave izoluese.

Koha e hapur e punës është rreth 2 orë në varësi të kushteve të motit. Temperatura e ajrit dhe e nënshtresës gjatë aplikimit dhe tharjes së ngjitësit duhet të jetë ndërmjet 5°C dhe 30°C.

Lesh Guri



Panel leshi guri izolues



Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Izolim termik special (përçueshmëri e ulët termike)Siguria nga zjarri - material jo i djegshëmZbutje shumë e mirë e zhurmës (koeficient i lartë përthithjeje)
--------------------	---

Përshkrimi

Panelet izoluese përdoren për izolim termik, të zhurmës dhe të zjarrit në ndërtimet civile, industriale ose detare:

- muret ndarëse me performancë të specifikuar të rezistencës ndaj zjarrit;
- mureve të kutive metalike të sallave
- muret e shtëpive me strukturë druri

Panelet e leshit të gurit përfitohen duke shkrirë lëndët e para minerale në furrë, duke e fibëruar shkrirjen nëpërmjet procesit REX. Më pas aplikohet një lidhës duke e spërkatur dhe shtohen vajra minerale për mbrojtjen kundër depërtimit të pluhurit dhe për hidrofobizim të produktit. Fijet minerale si rezultat i këtij procesi përpunohen në linjën e prodhimit në formën e panelit.

Përçueshmëria termike	0.035 λ D
Klasifikimi i reagimit ndaj zjarrit	A1

XPS



Panel polistireni i ngjeshur



Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Rezistencë të lartë ndaj impaktit mekanikVeçori shumë të mira të izolimit termikRezistencë e përhershme ndaj lagështisë
--------------------	---

Përshkrimi

Panele të ngjeshura polistireni për izolim termik dhe mbrojtjen e mureve dhe tarracave të sheshta nga goditja mekanike.

Përçueshmëria termike	0.034 λ D
Klasifikimi i reagimit ndaj zjarrit	B1

EPS



Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• Veçori shumë të mira të izolimit termik• Veçori mekanike të shkëlqyera• Rezistencë e përhershme ndaj lagështisë
--------------------	---

Përshkrimi

Panel izolues të fasadës termike të bëra nga shkumë polistireni për sistemet e jashtme të izolimit termik.

Përçueshmëria termike	0.036 λ D
Klasifikimi i reagimit ndaj zjarrit	B1

EPS Grafiti



Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• Veçori shumë të mira të izolimit termik• Veçori mekanike të shkëlqyera• Rezistencë e përhershme ndaj lagështisë
--------------------	---

Përshkrimi

Material izolues me përbërje grafiti i gjeneratës së re me aftësi izoluese të përmirësuara.

Përçueshmëria termike	0.032 λ D
Klasifikimi i reagimit ndaj zjarrit	B1

Webertherm rrjetë fasade



Paketimi:	55m ²
Çertifikatat:	ETA
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• është në përputhje me të gjitha karakteristikat e termoizolimit.

Përshkrimi

weber.therm rrjetë fasade, e prodhuar nga Saint-Gobain Adfors, është një rrjetë e cilësisë së lartë me fibra xhami, rezistente ndaj alkaleve, për instalim në sistemin e jashtëm të termoizolimit. Ajo peshon 145g/m² ose 160kg/m² dhe ka qendrueshmëri në tërheqje >2000 N/5cm me përmasa rrjetëzimi 4x4mm

Përdorimi

weber.therm rrjetë fasade përdoret si shtresë përforcuese në sistemet e termoizolimit me lesh guri, EPS, XPS dhe për armim në sipërfaqe çimentike.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Rulon
Pesha	55m²/rulon
Ngjyra	Verdhë me logo Weber
Konsumi	1.1m²

Kufizimet

weber.therm rrjetë fasade nuk aplikohet kurrë në kombinim me ngjitësit për termoizolim, por mund të instalohet në ngjitës që janë të aplikuar me teknikën “e lagur mbi të lagur”. Kjo kupton që shtresa e parë duhet të jetë ngjitës i aplikuar ku vendoset rrjeta dhe më pas, pa u tharë plotësisht, aplikohet shtresa mbuluese mbi rrjetë.

Aplikimi

weber.therm rrjetë fasadë aplikohet mbi sipërfaqen e ngjitësit të termoizolimit me një mallë metalike. Për aplikim në sistem me polisterol ne përdorim ngjitës nga familja weber.therm. Për aplikim në sistem me lesh guri përdoret ngjitësi weber.therm prestige. Rrjeta duhet të instalohet në 1/3 e shtresës përforcuese pa u ngjeshur në thellesi. Aplikohet me metodën “e lagur mbi të lagur” dhe mbulohet me ngjitës në trashësi 1mm. Pas aplikimit, rrjeta e tepërt pritët dhe hiqet. Kur instalimi të përfundojë, rrjeta nuk duhet të duket.



Webertherm SD-5

UPA INOVATIVE PA PËRCJELLSHMËRI TERMIKE



Paketimi:	100 copë
Çertifikatat:	ETA
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• Instalim i shpejtë dhe eficient me vetëm dy goditje çekiçi• Vendosje perfekte në mur• Përshtatje shkëlqyer me suvanë/ngjitësin

Përshkrimi

weber.therm SD-5 upa fasade me kokën e re gjashtëkëndore për të parandaluar rrëshqitjen dhe mundësinë e humbjes së upës gjatë punimeve. E përshtatshme për të gjitha sipërfaqet dhe pllakat e izolimit termik. Paketimi është i përshtatshëm dhe kompakt çka e bën më komode mbajtjen e tyre në kantier.

Përdorimi

Upat **weber.therm SD-5** janë të certifikuara ETA dhe janë të përshtatshme për të gjitha nënshtresat (beton, tullë, beton-gaz, beton me agregatë të lehtë) dhe të gjitha pllakat e izolimit termik.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kuti
Pesha	100copë/kuti
Konsumi	6 copë/m²

Aplikimi

Paketimi është i përshtatshëm dhe kompakt çka e bën më komode mbajtjen e tyre në kantier. Instalimi është ekstremisht i lehtë me vetëm dy goditje çekiçi




Aksesorë për Sistemet e Termoizolimit

Profil me rrjetë për dritare me gominë ngjitëse nga të dy anët



2.4ml

Profil pikore për dritare për këndet horizontale




2.5ml

Profil për dritare me rrjetë dhe me gominë ngjitëse biadezive




2ml

Profil alumini për xokolat



2.5ml

Profil këndore me rrjetë 10cm dhe me plastikë për të gjitha këndet



2.5ml

Profil final alumini (në fund të fasadës)



2.5ml

Profil fillestar për fasadën termike



2ml

Weberprim S&S

Bazë/primer për fasadat Extraclean



ZONA E APLIKIMIT



APLIKIM ME RUL



TEMPERATURA E LEJUAR

Përshkrimi

Bazë/primer silikat-silikon për fasadat. Përdoret për përgatitjen e bazamenteve minerale dhe fasadave, neutralizimin, forcimin dhe rezistencën ndaj ujit, përpara aplikimit të bojrave të fasadës dhe grafiatos silikate, silikone dhe Extraclean.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.20 kg/m ²

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Duhet mbrojtur nga ngrica. Përpara aplikimit, weber.prim S&S hollohet me 20% ujë. Aplikohet me furçë ose rul. Koha tharjes është 24h.

Weberprim Akril

Astar akril për fasada



ZONA E APLIKIMIT



KOHË E HAPUR PUNE



APLIKIM ME RUL

Përshkrimi

weber.prim akril është astar / bazë që përdoret për trajtimin e nënshtresës para aplikimit të produkteve përfundimtare, kryesisht, bojrave për fasadë dhe grafiatos. Përdoret për trajtimin e nënshtresës para aplikimit të produkteve përfundimtare. Balancon dhe u jep njëtrajtshmëri nënshtresave.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Bidon
Pesha	3L/Bidon
Ngjyra	Transparent
Konsumi	0.20 - 0.30 kg/m ²

Aplikimi

weber.prim akril para përdorimit duhet të miksohet mirë, dhe pastaj të hollohet me ujë. Në sipërfaqet e thata ose absorbuese, aplikimi bëhet në dy shtresa, me interval prej 2 deri në 3 orë. Në aplikimin e parë shtresa të tretet maksimalisht me 30% ujë, ndërsa në të dytin maksimalisht me 10 %.



Weberprim Beton Kontakt



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Përpara aplikimit të llaçit dhe nivelimit të shtresësE përshtatshme për mure të thataNgjyrë e kuqe pas tharjes

Përshkrimi

Bazë/primer për trajtimin e sipërfaqeve të betonit. Përdoret para suvatimit me llaç dhe para shtrimit të pllakave, mund të përdoret edhe për trajtimin e pllakave të gipsit.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Kuqe
Konsumi	0.15 - 0.30 kg/m²

Udhëzime mbi aplikimin

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Përpara se të aplikohet veshja, nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa njolla vaji. Duhet mbrojtur nga ngrica.

Aplikimi

Astari/baza duhet aplikuar i paholluar me një furçë, rul ose të sprucohet në sipërfaqen e betonit. Nëse aplikohet në beton të sapobërë, produkti duhet holluar me ujë në raportin 1:1. Betoni duhet të jetë të paktën 3 muajsh me maksimumi 2.5% përmbajtje lagështire. Për punime të brendshme, është e nevojshme të ketë ventilim intensiv. Koha e tharjes është së paku 3 orë. Produkti nuk përdoret në sipërfaqe të lagura ose të njoma.



Weberprim Podloga



Paketimi:	3L
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Përgatitet dhe aplikohet lehtëPër ambiente të brendshmePërmirësim i ngjytjes dhe rrafshim i imët

Përshkrimi

Bazë/primer akrilike i përqëndruar për përgatitjen e sipërfaqeve të brendshme përpara aplikimit të bojrave apo llaçit të patinimit.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë
Pesha	3L/kovë
Ngjyra	Transparent
Konsumi	0.20 - 0.30 kg/m²

Udhëzime mbi aplikimin

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Përpara se të aplikohet veshja, nënshtresa duhet të jetë e pastër, e thatë dhe pa njolla vaji. Duhet mbrojtur nga ngrica.

Aplikimi

weber.prim podloga IN duhet të miksohet mirë përpara se të përdoret, dhe më pas të hollohet me ujë në raportin 1:8 (1 për astarin, 8 për ujin). Përdorni një rul ose sprucojeni për të aplikuar astarin e holluar. Nëse sipërfaqja e murit është shumë e thatë ose absorbuese, vendosja e astarit duhet bërë dy herë.

Weberprim Reflect

Bazë/primer për fasadat REFLECT





ZONA E APLIKIMIT



ETICS



+5°C
TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Key Facts:	<ul style="list-style-type: none">Fikson dhe rrit papërshkueshmërinë nga ujiMundëson ngjitje më të mirë të fasadësZgjat kohën e punueshmërisë së suvasë së fasadës përfundimtare

Përshkrimi

Weberprim Reflect është një astar/bazë e krijuar në bazë të lidhësit akrilik e cila ka funksionin e forcimit dhe rritjes së ngjitjes së shtresës së ardhshme dhe rritjen e rezistencës ndaj ujit. weberprim Reflect është shtresa bazë që përdoret për përgatitjen e nënshtresës përpara se të aplikoni shtresën përfundimtare të suvasë së fasadës webertene Reflect. Krijon një barrierë kundër ujit midis suvasë së fasadës dhe ngjitësit të fasadës dhe në këtë mënyrë parandalon depërtimin e lagështisë nga atmosfera. weberprim Reflect lyen nënshtresën dhe e unifikon atë për sa i përket përthithjes së ujit, lidh pluhurin dhe pjesët e tjera të pranuar keq që nuk mund t'i hiqim duke i pastruar për asnjë arsye. Zgjat kohën e punueshmërisë së suvasë përfundimtare të fasadës.

Mënyra e aplikimit

Përpara instalimit, weberprim Reflect përzihet mirë dhe hollohet me ujë max. deri në 30%. Për rezultat më të mirë, rekomandojmë që shtresat të aplikohen dy herë duke u holluar deri në 30% me ujë në shtresën e parë dhe duke u holluar deri në 10% me ujë për shtresën e dytë. weberprim Reflect

aplikohet me një rul me lesh me qime të gjatë (gjatësia e fibrave 18-20 mm), furçë për lyerje me bojëra dispersioni ose llak. Kur aplikoni shtresën bazë me rul, rekomandohet përdorimi i një rrjete shtrydhëse. Temperatura e nënshtresës dhe ajrit gjatë aplikimit dhe tharjes së produktit duhet të jetë midis +5°C dhe +35°C, dhe tharja midis dy shtresave për 4-6 orë. Shtresat pasuese me llaç fasade ose materiale të tjera mund të aplikohen 24 orë pas instalimit të weberprim Reflect. Të gjithë parametrat e mësipërm i referohen kushteve standarde të motit: temperatura e ajrit 20°C. Lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që e gjithë procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna dhe të llogaritet në tharje më të shpejtë në mot të ngrohtë ose më ngadalë në mot më të ftohtë. Nëse vëreni një problem gjatë aplikimit, ndaloni funksionimin dhe telefononi një përfaqësues të shitjeve të Weber.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë
Konsumi	0.2 kg/m ² /shtresë

Aplikimi

Të gjitha nënshtresat mbi të cilat aplikohet duhet të përgatiten paraprakisht: të thata, të sheshta, të pastra, të forta, pa njolla vaji, pa pjesë të dëmtuara ose të dobëta. Mbetjet e bojës së vjetër, gëlqeres dhe papastërtive ekzistuese duhet të hiqen plotësisht paraprakisht. Nëse nënshtresa është e ekspozuar ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohen dëmtimet që shkaktojnë shfaqjen e lagështirës ose të vendoset një shtresë izoluese që do të parandalojë ardhjen e drejtpërdrejtë të lagështirës në shtresën përfundimtare. Nëse ka sipërfaqe me myk, para lyerjes, sigurohuni që t'i shkatërroni me dezinfektues. Me sistemin e fasadës Webertherm Reflect, ngjitësi i aplikuar thahet për të paktën 1 ditë për çdo milimetër të trashësisë së ngjitësit përpara se të aplikohet weberprim Reflect.

Weberprim Aquabalance

Bazë/primer për fasada Aquabalance





ZONA E APLIKIMIT



APLIKIM ME FURÇË



+5°C
TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Key Facts:	<ul style="list-style-type: none">Përdoret për përgatitjen e nënshtresës përpara suvasë së fasadësPër çdo lloj sipërfaqe fasadePërforcon dhe rrit kundërveprimin me ujin

Përshkrimi

weberprim AquaBalance është një shtresë bazë e bërë në bazë të një lidhësi akrilik që ka funksionin e fiksimit dhe rritjes së rezistencës ndaj ujit. Astar/baza lyen nënshtresën dhe e unifikon atë për sa i përket përthithjes së ujit, rrit ndjeshëm rezistencën ndaj ujit, lidh pluhurin dhe pjesët e tjera të pranuar keq që nuk mund t'i hiqim duke i pastruar për shumë arsye. Zgjat kohën e punueshmërisë së suvasë dekorative të fasadës. Përdoret për të gjitha llojet e sipërfaqeve të fasadave (llaç mineral, çimento dhe gëlqere, beton...) përpara vendosjes së suvase dekorative të fasadës Webertene AquaBalance.

Përdorimi

Përziejeni mirë Weberprim AquaBalance përpara instalimit. Për rezultat më të mirë, rekomandojmë që veshja të aplikohet dy herë duke u holluar deri në 30% me ujë në shtresën e parë dhe duke u holluar deri në 10% me ujë për shtresën e dytë. weberprim AquaBalance aplikohet me një rul, me

lesh me qime të gjatë ose bojë tekstili (gjatësia e fibrave 18-20 mm), furçë për lyerje me bojëra dispersioni ose llak. Kur aplikoni shtresën bazë me rul, rekomandohet përdorimi i një rrjete shtrydhëse. Temperatura e nënshtresës dhe e ajrit gjatë aplikimit dhe tharjes së produktit duhet të jetë midis +5°C dhe +35°C, dhe tharja midis dy shtresave për 3-4 orë. Aplikimi i llaçit të fasadës ose materialeve të tjera lejohet 24 orë pas tharjes së Weberprim AquaBalance. Të gjithë parametrat e mësipërm i referohen kushteve standarte të motit: temperatura e ajrit 20°C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që e gjithë procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna dhe të llogaritet në tharje më të shpejtë në mot të ngrohtë ose më ngadalë në mot më të ftohtë. Nëse vëreni një problem gjatë aplikimit, ndaloni punën dhe telefononi një përfaqësues të shitjeve të Weber.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.15-0.30 kg/m ²

Aplikimi

weberprim AquaBalance është astar/ bazë e përdorur për përgatitjen e nënshtresës përpara aplikimit të shtresës përfundimtare të suvasë dekorative të fasadës webertene AquaBalance. Ai krijon një barrierë kundër ujit midis suvasë së fasadës dhe ngjitësit të fasadës dhe në këtë mënyrë parandalon depërtimin e lagështisë nga atmosfera. Astar/baza lyen nënshtresën dhe e unifikon atë për sa i përket përthithjes së ujit, rrit ndjeshëm rezistencën ndaj ujit, lidh pluhurin dhe pjesët e tjera të pranuar keq që nuk mund t'i hiqim duke i pastruar për shumë arsye. Zgjat kohën e punueshmërisë së suvasë dekorative të fasadës. Përdoret për të gjitha llojet e sipërfaqeve të fasadave (llaç mineral, çimento dhe gëlqere, beton...) përpara vendosjes së suvasë dekorative të fasadës Webertene AquaBalance.

Weberprim Steel



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Me fibra speciale polipropileniE qëndrueshme në të gjitha kushtet e motitPërdorim kryesor në riparime

Përshkrimi

Weberton Steel është një bojë akrilike e përforcuar me fibra të veçanta polipropileni, rezistente ndaj të gjitha kushteve të motit. Weberton Steel është menduar lyerje riparuese e suvave të vjetra dekorative dhe për mbulimin e çarjeve të holla në sipërfaqet e fasadës.

Përdorimi

Gjatë aplikimit të parë, nënshtresa hollohet me maksimum 30% ujë dhe aplikimi i dytë me maksimum 10% ujë. Aplikojeni me furçë ose rul. Për sipërfaqet e thata dhe absorbuese aplikoni dy shtresa primeri, në intervale nga 2 deri në 3 orë. Koha e tharjes minimalisht 24 orë.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.25 - 0.4 kg/m² (2 shtresa)

Aplikimi

weber.prim steel përdoret para aplikimit të bojrave të fasadave dhe suvave dekorative me shtresë të hollë.

Këshilla

Temperatura e ajrit dhe e nënshtresës për punë dhe tharje mbi 5°C dhe nën 30°C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të erës, diellit dhe reshjeve - mbrojtja nga dielli dhe era mund të jetë një rrjetë mbrojtëse fasade, por e pamjaftueshme nëse këta faktorë të motit janë të rënduar. Mbroni nga ngrirja.

Shënim

Të gjithë këto parametra i referohen kushteve standarte të motit - temperatura 20°C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuara është në përputhje me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit të veshjeve bazë. Kompania nuk mban përgjegjësi për kryerjen e parregullt të punës me materialin e specifikuar, për përdorimin e materialeve për qëllime që nuk specifikohen në përshkrimin e produktit, si dhe për kryerjen e punës në kushte moti që nuk janë në përputhje me përshkrimin e specifikuar të produktit. Weber rekomandon që sipërfaqet e provës të bëhen përpara fillimit të punës. Kompania pranon ankesa vetëm për cilësinë e produktit, nëse ai ruhet, përgatitet dhe zbatohet sipas udhëzimeve të nxjerra.

Webertene Silikonputz



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">I papërshkueshëm nga ujiGati për përdorimAplikohet lehtësisht

Përshkrimi

Grafiato me grimca silikon, me qëndrueshmëri të lartë të ngjyrës. Përdoret si shtresë përfundimtare dekorative, në të gjithë sistemet ETICS. E përshtatshme për zona urbane me ndotje të lartë.

Përdorimi

weber.tene silikonputz përdoret si shtresë përfundimtare për përdorime të jashtme, dekorimin dhe mbrojtjen e mureve me karakteristika termoizolimi; mund të përdoret për punime të brendshme. Për të gjitha nënshtresat e vjetra dhe të reja. Nëse aplikohet në sipërfaqe të vjetra me ndikim nga kripa, është e nevojshme t'i veshësh ato me weber.prim hydrosol, astarin kundër kripës. Aplikimi i saj është i përshtatshëm në zona klimatike me lagështirë të lartë për shkak të kundërveprimit të shkëlqyer me ujin.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	2.5 - 3.5 kg/m²

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Të paktën 24 orë para aplikimit të materialit në sipërfaqen e dëshiruar, nënshtresa duhet të vishet me astarin e ngjyrosur weber.prim S&S në 100% të sipërfaqes. weber.tene silikonputz duhet të miksohet në kovë deri në fund përpara se të aplikohet . Weber sugjeron të miksohen disa kova në një enë të madhe që të përftohet një përbërje e homogjenizuar dhe pa ndryshime në nuancën e ngjyrës. Suvaja aplikohet duke përdorur një mallë metalike gjithmonë në të njëjtin drejtim dhe me frekuencë konstante levizjesh pavarësisht se sa njerëz punojnë një një projekt. Strukturimi bëhet me anë të një malle plastike menjëherë pas aplikimit të suvasë. Rekomandohet të përdoret bojë me reflektim drite >30, sepse ngjyrat e errëta krijojnë një handicap për fasadën, përthithin më shumë nxehtësi dhe krijojnë një diferencë të lartë temperaturash midis ditës dhe natës. Gjithashtu, pigmentet e errëta prishin reaksionin kimik të suvasë së silikonit dhe rrisin mundësinë e shfaqjes së tonaliteteve.

Performanca

Përshkueshmëria e avujve të ujit	<43 μ
Forca ngjitime	≥1.0 MPa
Përshkueshmëria e ujit	E papërshkueshme

Webertene Silikatputz



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• Përshkueshmëri të lartë të avujve• I papërshkueshëm nga uji• Gati për përdorim

Përshkrimi

Grafiato me grimca silikati, me përshkueshmëri të lartë të avujve. Përdoret si shtresë përfundimtare dekorative, në të gjithë sistemet ETICS.

Përdorimi

weber.tene silikatputz përdoret si shtresë përfundimtare për përdorime të jashtme, dekorimin dhe mbrojtjen e mureve me karakteristika termoizolimi; mund të përdoret për punime të brendshme. Nënshtresa ku aplikohet duhet të jetë minerale. Nuk rekomandohet të aplikohet në sipërfaqe që përmbajnë gëlqere apo gips.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	2.5 - 3.5 kg/m²

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – Ne aplikimet ne fasade, mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Në këtë rast ndërpritet puna dhe vazhdohet kur kushtet e motit të jenë të qendrueshme. Të paktën 24 orë para aplikimit të materialit në sipërfaqen e dëshiruar, nënshtresa duhet të vishet me astarin e ngjyrosur weber.prim S&S në 100% të sipërfaqes. weber.tene silikatputz duhet të miksohet në kovë deri në fund te saj përpara se të aplikohet. Weber sugjeron të miksohen disa kova në një enë të madhe që të përftohet një përbërje e homogjenizuar dhe pa ndryshime në nuancën e ngjyrës. Suvaja aplikohet duke përdorur një mallë metalike gjithmonë në të njëjtin drejtim dhe me frekuencë konstante lëvizjesh pavarsisht se sa njerëz punojnë një një projekt. Strukturimi bëhet me anë të një malle plastike menjëherë pas aplikimit të suvasë. Rekomandohet të përdoret bojë me reflektim drite >30, sepse ngjyrat e errëta krijojnë një handicap për fasadën, përthithin më shumë nxehtësi dhe krijojnë një diferencë të lartë temperaturash midis ditës dhe natës. Gjithashtu, pigmentet e errëta prishin reaksionin kimik të suvasë së silikonit dhe rrisin mundësinë e shfaqjes së tonaliteteve.

Performanca

Qendrueshmëria	≤23
Përshkueshmëria e ujit	40 μ
Forca ngjitetëse	≥0.39 MPa

Webertene ExtraClean



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• I papërshkueshëm nga uji• Përshkueshmëri të lartë të avujve• Efekt vetëpastrues

Përshkrimi

weber.tene ExtraClean është një suva shtresëhollë dekorative me aftësi të vazhdueshme vetëpastruese dhe me teknologji elektrostatische në sipërfaqen e saj. Bashkon të gjitha cilësitë e mira të silikatit dhe silikonit dhe duke përdorur cilësite unike, e bën një shtresë finale adapte për të gjithë llojet e fasadave dhe ambienteve që aplikohet. Duke qenë një produkt novator me aftësi vetëpastruese, bën që të reduktohen në maksimum kostot e mirëmbajtjes dhe të zgjasë jetën dhe cilësinë e fasadës. Falë përmbajtjes shumë të vogël të grimcave organike, produkti krijon një ngarkesë elektrostatische dhe pluhuri së bashku me myshqet nuk ngjitet në fasadë. Në të njëjtën kohë fasada është hidrofobike dhe e pastër, duke bërë që në fasadë të ulët efekti i lagështirës dhe mos krijohet një ambient i përshtatshëm për rritjen e algave apo mikroorganizmave të tjerë.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	2.1 - 3.5 kg/m²

Përdorimi

webertene ExtraClean përdoret si shtresë finale për përdorim të jashtëm, dekorim dhe mbrojtje të fasadave, me karakteristika termoizoluese. Është i përshtatshëm për përdorim në sistemet termoizoluese me EPS, Grafit EPS dhe XPS. Përdoret në ndërtimet e reja si edhe në rindërtimin, modernizimin dhe rinovimin e fasadave të vjetra. I përshtatshëm për përdorim brenda dhe jashtë. Mund të përdoret në vende me ndotje të lartë dhe përmbajtje agresive të ajrit.

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe temperatura e sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të erës, diellit apo shiut - mbrojtja nga dielli dhe era duhet të jetë një rrjetë skele, por jo e mjaftueshme nëse kushtet atmosferike janë të rënda. weber.tene Extraclean aplikohet me një malle çeliku në një shtresë të trashë sa kokrra më e madhe në sipërfaqen e astarosur më përpara. Strukturimi bëhet me një mistri plastike ndërkohë që produkti është ende i lagësht dhe i punueshëm. Weber rekomandon përzierjen e disa kovave për rezultate më të mira të nuancës së ngjyrës. Rekomandohet përdorimi i ngjyrave me reflektim të dritës > 30, sepse tonet më të errëta rëndojnë fasadën, thithin më shumë nxehtësi dhe bëjnë një ndryshim më të madh të temperaturës mes ditës dhe natës. Gjithashtu, pigmentet më të errëta ndikojnë në suvanë dekorative silicate duke bërë reaksion kimik dhe rrisin mundësinë e gabimit në tonalitetin e ngjyrave.

Performanca

Absorbimi i ujit	W0
Përshkueshmëria e avullit të ujit (μ)	≤70
Forca ngjitetëse	≥0.75 “B” MPa

Webertene Akрилputz



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Gرافيato akrilikeI papërshkueshëm nga ujiE qëndrueshme në dritë

Përshkrimi

Gرافيato akrilike standarte. Përdoret si shtresë përfundimtare dekorative, në të gjithë sistemet ETICS.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	2.5 - 3.5 kg/m²

Përdorimi

webertene Akрилputz Plus është një suva dekorative e avancuar për fasadë me konsum të reduktuar. webertene Akрилputz Plus është i papërshkueshëm nga uji dhe i qëndrueshëm ndaj dritës, me përshkueshmëri adekuate të avullit. Ai

plotëson të gjitha kërkesat teknike dhe ekonomike që materiali final duhet të ketë në sistemin e termoizolimit. Kombinimi i materialeve të përputhura mirë mundëson punueshmëri të lehtë dhe qëndrueshmëri të fasadave.

Aplikimi

Weberten Akрилputz Plus është një shtresë përfundimtare për përdorim të jashtëm, dekorim dhe mbrojtje të mureve, me karakteristika termoizoluese; mund të përdoret edhe për përdorim të brendshëm. Është i përshtatshëm për të gjitha llojet e shtresave të llaçit dhe betonit. Nuk rekomandohet aplikimi i tij në nënshtresa organike, si dhe në nënshtresa të vjetra dhe me ngarkesë të pamjaftueshme. 24 orë para fillimit të aplikimit të produktit Weberten Akрилputz Plus, nënshtresa mbi të cilin aplikohet shtresa përfundimtare duhet të lyhet me Weberprim Akрил me një shtresë ngjyre mbi 100% të sipërfaqes. Weberten Akрилputz Plus përzihet në një kovë deri në fund përpara aplikimit. Rekomandimi i Weber është që gjithmonë të përzihen disa kova në një enë më të madhe për uniformitet të nuancës së ngjyrës. Llaçi aplikohet me mistri metalike gjithmonë në të njëjtin drejtim dhe me të njëjtën frekuencë lëvizjeje, pavarësisht se sa njerëz punojnë në një objekt. Struktura arrihet me mistri plastike, menjëherë pas aplikimit të llaçit.

Këshilla

Temperatura e ajrit dhe e nënshtresës për punë dhe tharje duhet të jetë mbi 5 ° C dhe nën 30 ° C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të erës, diellit dhe reshjeve - mbrojtja nga dielli dhe era mund të bëhet me një rrjetë mbrojtëse fasade, por jo e mjaftueshme nëse këta faktorë të motit janë të rënduar. Nuk rekomandohet aplikimi i tij në sipërfaqe horizontale (tavane, dysheme). Nuk rekomandohet aplikimi i tij në nënshtresa të vjetra dhe jo të konsumuara.

Shënim

Të gjithë parametrat e mësipërm i referohen kushteve standarte të motit - temperatura 20 ° C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna. Weber rekomandon që sipërfaqet e provës të bëhen përpara fillimit të punës. Nëse vëreni një problem gjatë aplikimit, ndaloni punën dhe telefononi një përfaqësues të shitjeve të Weber.

Webertene Aquabalance



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Rregullon dhe parandalon lagështirënPërmirëson tharjen e shpejtë të pikave të ujitRezistente ndaj temperaturave deri në -40°C

Përshkrimi

webertene AquaBalance është një suva dispersive, në të cilën zhvillohet një proces fizik absorbimi kapilar. Proces i është funksional që nga dita e parë përgjatë gjithë jetëgjatësisë së fasadës. Lejon një kontroll të lartë të lagështirës së sipërfaqes dhe përshpejton tharjen e shtresës finale. Pas shiut, lagështira, e cila është një habitat natyral për algat dhe myshqet, avullon shpejt gjë që parandalon formimin e mikroorganizmave.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Sipas Katalogut
Konsumi	2.1 - 3.5 kg/m²

Përdorimi

webertene Aquabalance përdoret si veshje përfundimtare për përdorim të jashtëm, për dekorimin dhe mbrojtjen e mureve me karakteristika izolimi termik. Mund të përdoret në sistemet e izolimit termik me polisterol dhe lesh guri.

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut - mbrojtja nga dielli dhe era mund të bëhet nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Rekomandohet të përdoret bojë me reflektim drite >30, sepse ngjyrat e errëta krijojnë një handicap për fasadën, përthithin më shumë nxehtësi dhe krijojnë një diferencë të lartë temperaturash midis ditës dhe natës. Gjithashtu, pigmentet e errëta prishin reaksionin kimik të suvasë së silikonit dhe rrisin mundësinë e shfaqjes së hijeve. webertene Aquabalance aplikohet me mallë metalike në një trashësi shtrese sa kokrriza më e madhe në sipërfaqen e lagur më parë. Strukturimi bëhet me një mallë plastike ndërkohë që përzierja është akoma e lagësht dhe e punueshme. Weber rekomandon të miksohen disa kova për rezultate hijëzimi më të mira.

Performanca

Reagimi ndaj zjarrit	A2-S1, d0
Absorbimi i ujit	W1
Përshkueshmëria e ujit (μ)	V1
Forca ngjitëse	≥0.3 N/mm²

Webertene Reflect



ZONA E APLIKIMIT

ETICS

TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Grafiato për ngjyrat e forta në termoizolimNgjyrë sipas kërkesës

Përshkrimi

Grafiato e krijuar posaçërisht për fasadat me nuanca të errëta. Përdoret si shtresë përfundimtare dekorative, në të gjithë sistemet ETICS.

Përgatitja e nënshtresës

Sipërfaqja në të cilën aplikohet produkti duhet të jetë e sheshtë, e pastër, e fortë, e thatë, pa yndyrë dhe pa pjesë të shkëputshme apo të dobëta. Riparoni të gjitha gropëzimet, valëzimet dhe dëmtimet përpara fillimit të punës. Mbetjet e bojës së vjetër, gëlqeres dhe papastërtive ekzistuese duhet të hiqen plotësisht dhe të sigurohemi që nënshtresa është e shëndetshme. Nëse suvaja dekorative webertene Reflect, aplikohet në sipërfaqet e sapo suvatuara, nenshtresa, llaçi i çimentos, duhet të thahet për min. 7 -10, një ditë për çdo cm trashësi. Niveloni më përpara sipërfaqet e bazamentit me llaç çimentoje por asnjëherë me ngjitës! Nënshtresat e reja të betonit duhet të jenë të vjetra minimalisht 28 ditë. Nëse nënshtresa është e ekspozuar ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohet dëmtimi që shkakton shfaqjen e lagështirës ose të vendoset

një shtresë izoluese që do të parandalojë ardhjen e drejtpërdrejtë të lagështirës. Mbi këtë shtresë do të aplikohet webertene Reflect. Nënshtresat shumë absorbuese dhe të vjetra duhet të lyhen me astarin/bazën përforcuese weberprim deep, i cili bën përforsim të mbetjeve të bojës të lidhura dobët dhe materialeve të tjera. Për sipërfaqet e suvatuara, kontrolloni ngjitjen e vetë llaçit që shërben si nënshtresë. Në sistemin e termoizolimit webertherm reflect, llaçi i fasadës aplikohet pas tharjes së astarit të weberprim Reflect, i cili aplikohet kur ngjitësi termoizolues me përforsim të dyfishtë webertherm reflect është plotësisht i tharë – 1mm në ditë. Sigurohuni që të gjitha shtresat e mëparshme të jenë plotësisht të thata.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Kuqe
Konsumi	3.0 - 3.5 kg/m²

Aplikimi

Përmbajtja e paketimit Webertene Reflect përzihet mirë me një mikser elektrik dhe, nëse është e nevojshme, hollohet me ujë duke shtuar maksimumi 100 ml ujë në një kovë 25 kg. Para aplikimit, sigurohuni që të kontrolloni nuancën dhe të njehsoni ngjyrën e produktit duke përzier disa kova në një enë të madhe! Kur kemi përdorur përafërsisht suva të njëjtë të fasadës nga një enë të madhe me material te përgatitur më përpara, shtojmë përmbajtjen e kovës së re dhe e përziejmë mirë me suvanë dekorative të mbetur në enë e madhe etj. Nuk është i nevojshëm përzierja e kovave të produktit kur ngjyra që do të aplikoni do të jetë e bardhë. Nuk lejohen riparime apo shtim uji në suvanë e fasadës webertene reflekt gjatë instalimit! Pastroni skelën para se të filloni vendosjen e astarit/ bazës dhe aplikimin e webertene Reflect! Weber rekomandon që të bëhen sipërfaqe më të vogla provë përpara fillimit të punës, për të kontrolluar qëndrueshmërinë, ngjyrën dhe cilësinë e produktit. Nëse vëreni ndonjë devijim nga cilësia kur bëni sipërfaqen e provës, ju lutemi ndaloni punën dhe kontaktoni një përfaqësues të Weber për problemin e evidentuar dhe mos punoni me atë sasi produkti.

Webertene Kulir



ZONA E APLIKIMIT

APLIKIM ME MALLË

TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">I papërshkueshëm nga ujiGati për përdorimAplikohet lehtësisht

Përshkrimi

Grafiato akrilike me përbërje gurësh natyrorë, rezistent ndaj të gjitha ndikimeve të jashtme, i qëndrueshëm ndaj dritës dhe i papërshkueshëm nga uji, për mbrojtje maksimale të fasadës. Përdoren kryesisht në bazamentin e fasadës apo në parapetet e tarracave, ku ka mundësi ndotje nga shiu.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Sipas Katalogut

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Të paktën 24 orë para aplikimit të materialit në sipërfaqen e dëshiruar, sipërfaqja duhet të lyhet me weber.prim akril për të ngopur dhe unifikuar nënshtresën. Përpara përdorimit, webertene kulir duhet të përzihet mirë në çdo kovë veç e veç para se të përdoret dhe më pas duhet të hidhen disa kova në një enë më të madhe dhe të përzihen në mënyrë që të përftohet një përbërje e homogjenizuar dhe pa ndryshime në nuancën e ngjyrës. webertene kulir nuk duhet përzier shumë gjatë që të mos bëhet në gjendje shumë të lëngshme dhe e vështirë për tu aplikuar. Mjafton të përzihet masa nga lart poshtë, në mënyrë që kokrrizat që kanë rënë në fund të ngrihen lart. webertene kulir aplikohet me mallë metalike në një drejtim, nga poshtë lartë, në të njëjtën trashësi (rreth 3mm) dhe gjithmonë në të njëjtin drejtim. Vazhdimisht pas aplikimit, sipërfaqja duhet niveluar. Nuk rekomandohet të aplikohet në sipërfaqe horizontale (tavane, dysheme). Nuk rekomandohet të aplikohet në sipërfaqe të vjetra dhe jo suportuese. Nuk rekomandohet të aplikohet mbi aplikime ekzistuese marmoliti, vetëm në qoftë se sipërfaqja është mjaftueshëm suportuese.

Webertene Karbokul



ZONA E APLIKIMIT

APLIKIM ME MALLË

TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Marmolit me gurë shumëngjyrësh të ngjyrosur artificialisht, të disponueshëm edhe në versionin me xixa.

Përshkrimi

Grafato akrilike me përbërje grimcash mermeri të ngjyrosur artificialisht, për mbrojtje maksimale të fasadës, duke krijuar kombinime të shumta. i qëndrueshëm në të gjitha kushtet e motit. Ka përshkueshmëri të jashtëzakonshme të avujve dhe rezistencë të lartë ndaj ujit. Përdoren kryesisht në bazamentin e fasadës apo në parapetet e tarracave, ku ka mundësi ndotje nga shiu.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Sipas Katalogut
Konsumi	4.5-5 kg/m²

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Të paktën 24 orë para aplikimit të materialit në sipërfaqen e dëshiruar, sipërfaqja duhet të lyhet me weber.prim akril për të ngopur dhe unifikuar nënshtresën. weber.tene karbokul NOIR duhet të përzihet mirë në çdo kovë veç e veç para se të përdoret dhe më pas duhet të hidhen disa kova në një enë më të madhe dhe të përzihen në mënyrë që të përftohet një përbërje e homogjenizuar dhe pa ndryshime në nuancën e ngjyrës. weber.tene karbokul aplikohet me një mallë metalike ose një spërkatës me pompë në trashësinë e kokrrës. Trashësia e shtresës përcaktohet në fazën e dytë të aplikimit kur materiali i tepërt hiqet me mallë. Më pas, shtresa e aplikuar rrafshohet me mistri për të mbushur boshllëqet ndërmjet kokrrave. Kur shtresa e aplikuar fillon të mpikset, sipërfaqja duhet të rrafshohet përsëri me mallë metalike. Nuk rekomandohet të aplikohet në sipërfaqe horizontale (tavane, dysHEME). Nuk rekomandohet të aplikohet në sipërfaqe të vjetra dhe jo suportuese. Nuk rekomandohet të aplikohet në mbi aplikime ekzistuese marmoliti, vetëm në qoftë se sipërfaqja është mjaftueshëm e qëndrueshme dhe e fortë.

Performanca

Përshkueshmëria e avujve (μ)	≤15
Fortësia e ngjitjes	≥0.58 N/mm²

Webertene Karbokul Noir



ZONA E APLIKIMIT

APLIKIM ME MALLË

TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Marmolit me gurë shumëngjyrësh të ngjyrosur artificialisht, të disponueshëm edhe në versionin me xixa.

Përshkrimi

Grafato akrilike me përbërje grimcash mermeri të zi me shkelqim shumëngjyrësh. Përdoret për dekorimin e sipërfaqeve vertikale të brendshme. Ka përshkueshmëri të jashtëzakonshme të avujve dhe largim të ujit.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Zezë
Konsumi	4.5-5 kg/m²

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Të paktën 24 orë para aplikimit të materialit në sipërfaqen e dëshiruar, sipërfaqja duhet të lyhet me weber.prim akril për të ngopur dhe unifikuar nënshtresën. weber.tene karbokul NOIR duhet të përzihet mirë në çdo kovë veç e veç para se të përdoret dhe më pas duhet të hidhen disa kova në një enë më të madhe dhe të përzihen në mënyrë që të përftohet një përbërje e homogjenizuar dhe pa ndryshime në nuancën e ngjyrës. weber.tene karbokul NOIR aplikohet me një mallë metalike ose një spërkatës me pompë në trashësinë e kokrrës. Trashësia e shtresës përcaktohet në fazën e dytë të aplikimit kur materiali i tepërt hiqet me mallë. Më pas, shtresa e aplikuar rrafshohet me mistri për të mbushur boshllëqet ndërmjet kokrrave. Kur veshja është pjesërisht e thatë, sipërfaqja duhet të rrafshohet përsëri.

Performanca

Përshkueshmëria e avujve (μ)	≤8
Fortësia e ngjitjes	≥0.3 N/mm²

Webermin Classic



Paketimi:	25Kg
Çertifikatat:	EN 998
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Fino dekorative me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griSipërfaqe vertikale dhe tavane

Përshkrimi

Webermin Classic është suva dekorative minerale, rezistente dhe jetëgjatë, me ngjyrë të bardhë dhe përshkueshmëri të lartë të avujve. E disponueshme në strukturat: R (me gervishtje) dhe K (e plotë). Përdoret si shtresë përfundimtare dekorative në muret e jashtëm dhe të brendshëm, në të gjitha nënshtresat minerale.

Përgatitja e bazamentit

6-12 ore para aplikimit të suvase dekorative, nënshtresa duhet të jetë trajtuar me astarin/bazën weberprim akril ose weberprim. S&S, për të njësuar sipërfaqen. Gjatë sezonit të nxehtë, në kushte të temperaturave shumë të larta, keshillohet që sipërfaqja të sperkatet me ujë para se të fillojë aplikimi i suvase dekorative. Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, keshillohet të mos kryhen punime në kushte të rënda të motit. Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	E bardhë dhe gri
Konsumi i ujit	5 - 5.5 L
Konsumi	1.5 - 2 mm
Kokërrzimi	K 1.5

Udhëzime mbi aplikimin

Përmbajtja prej 25kg e thesit përziejhet me mikser elektrik duke i shtuar gradualisht 5.5 - 7.5 l ujë sipas nevojës. Pas përzierjes së parë, masa lihet të prehet për rreth 10 min dhe më pas përziejhet përsëri para se të aplikohet. Përzierja e përgatitur aplikohet me mallë çeliku në të gjithë sipërfaqen e fasadës, në trashësinë e kokërrizës më të madhe. Struktura R (me gërvishtje) ose K (e plotë) jepet me mallë plastike, ndërkohë që produkti është ende i njomë.

Treguesit fiziko-mekanikë

Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	1.1 - 1.3 Gr/m³
Mbjetje 180 µ	30-50%
Uje-mbajtja	99%
Masa vëllimore e llaçit në 20°C	1600-1700 Kg/L
Pamja	E bardhë
Gjendja	Pluhur

Treguesit kimikë

Lagështira	0.10%
Aditivë	1.5%

Weberton Akril



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Qëndrueshmëri të mirë dhe rezistent ndaj ujitPër balancim dhe neutralizim

Përshkrimi

Bazë/primer akrilike për fasadat. Përdoret për përgatitjen e bazamenteve minerale dhe fasadave, neutralizimin, forcimin dhe rezistencën ndaj ujit, përpara aplikimit të bojrave të fasadës dhe grafiatos akrilike.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.15 - 0.30 kg/m²

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe temperatura e sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të kushteve atmosferike. Përpara aplikimit, sipërfaqja duhet të jetë trajtuar me astarin/bazën weber.prim akril. Boja duhet miksohet mirë përpara përdorimit. Nëse produkti është i ngjyrosur, Weber rekomandon të përziejhet një sasi më e madhe boje në një enë të madhe dhe më pas ta miksosh në mënyrë që përbërësi dhe ngjyra të homogjenizohen dhe eliminohen problemet me nuancë`n e ngjyrave. Për të parandaluar tonalitetet nuk rekomandohet të aplikohet shtresa në mure të sapo suvatuara dhe të pa tharë mirë, apo nën impaktin direkt të lagështirës. Produkti aplikohet me një rul ose furçë në dy shtresa. Shtresa e dytë aplikohet pasi shtresa e parë është tharë. Nuk rekomandohet të aplikosh weberton akril në sipërfaqe të vjetra të paqëndrueshme, sidomos nëse ka lagështirë në mure.

Weberton Bet



Paketimi:	5Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Ngjitës polimeriKundërveprim i lartë me ujin

Përshkrimi

Weberton Bet është një bojë e është bërë në bazë të lidhësve polimer dhe përdoret për lyerjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve të betonit vertikal dhe nënshtresave të tjera me bazë çimentoje. Weberton Bet karakterizohet nga ngjitje shumë e mirë ndaj nënshtresave të betonit, papërshkueshmëri e lartë e ujit si dhe rezistencë e lartë ndaj përshkueshmërisë së CO₂.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	5kg/kovë
Ngjyra	Sipas Katalogut
Konsumi	180-200 ml/m²

Përgatitja e nënshtresës

Të gjitha nënshtresat mbi të cilat aplikohet duhet të përgatiten paraprakisht: të thata, të sheshta, të pastra, të forta, të lyera, pa pjesë të demtuara. Tharja e sipërfaqeve të reja të betonit në kushte normale duhet të jetë së paku 1 muaj, dhe tharja e mureve të suvatuara imët me bazë çimento ose gëlqere duhet të jetë 7-10 ditë për çdo cm sipërfaqe të suvatuar. Mbetjet e bojës së vjetër, gëlqeres dhe papastërtive

ekzistuese duhet të hiqen plotësisht paraprakisht, kur Weberton bet përdoret edhe për lyerje restauruese. Nëse nënshtresa është e ekspozuar ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohen dëmtimet që shkaktojnë shfaqjen e lagështirës ose të vendoset një shtresë izoluese që do të parandalojë ardhjen e drejtpërdrejtë të lagështirës në shtresën përfundimtare. Nëse ka sipërfaqe të infektuara me myk, para lyerjes, sigurohuni që t'i shkatërroni me dezinfektues.

Përpara lyerjes së parë, lyeni nënshtresën me astar të holluar weberprim 813 (1:8,1 l astar/bazë dhe 8 litra ujë), mbi 100% të sipërfaqes në të cilën do të aplikohet basti weberton. Para shtresës së parë, edhe weberton bet po qe se hollohet me ujë në një raport 1:1, mund të përdoret si shtresë bazë. Për sipërfaqe më kërkuese dhe me cilësi të dobët, përdorni një astar me penetrim të thellë weberprim deep përpara shtresës së parë. Në sipërfaqet e fasadës, përpara se të përdorni Weberton bet, sigurohuni që fillimisht të aplikoni weberprim deep si dhe kur lyeni mbi pllaka me fibra çimento.

Udhëzime mbi aplikimin

Përpara aplikimit, weberton bet përzihet deri në fund dhe nëse është e nevojshme, hollohet me ujë deri në një maksimum prej 10%. Weber rekomandon të bëni sipërfaqe më të vogla provë përpara se të filloni punën për të kontrolluar nuancën e ngjyrës. Nëse vëreni ndonjë devijim nga cilësia kur bëni sipërfaqen e provës, ju lutemi ndaloni punën dhe kontaktoni një përfaqësues të shitjeve të Weber. Para se të aplikojmë bojën në sipërfaqe më të mëdha, për të cilat na duhen më shumë kova, duhet të barazojmë bojën. Ngjyra e bardhë nuk ka nevojë të barazohet. weberton bet aplikohet në dy shtresa me një rul me lesh me qime të gjatë (gjatësia e fibrës 18-20 mm), furçë për lyerje me bojëra dispersioni ose llak. Kur lyeni me rul, rekomandohet përdorimi i një rrjete shtrydhëse. Është e nevojshme të aplikohet vazhdimisht dhe pa ndërprerje në të gjithë sipërfaqen e murit për të shmangur pabarazitë që ndodhin për shkak të bashkimit të sipërfaqeve dhe tharjes së pabarabartë të produktit.

Temperatura e nënshtresës dhe ajrit gjatë aplikimit dhe tharjes së produktit duhet të jetë midis +5°C dhe +35°C, dhe tharja midis dy shtresave për 4-6 orë. Të gjithë parametrat e mësipërm i referohen kushteve standarte të motit: temperatura e ajrit 20°C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që e gjithë procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna dhe të llogaritet në tharje më të shpejtë në mot të ngrohtë ose më ngadalë në mot më të ftohtë. Nëse vëreni një problem gjatë funksionimit, ndaloni funksionimin dhe telefononi një përfaqësues të shitjeve të Weber.

Weberton Pastel



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Bojë fasade veçanërisht e bardhëI papërshkueshëm nga ujiRezistente ndaj të gjitha ndikimeve atmosferike

Përshkrimi

Weberton Pastel është një bojë fasade shumë e bardhë me fuqi mbuluese shumë të mirë, rezistente ndaj të gjitha ndikimeve atmosferike. E qëndrueshme në dritë dhe rezistente ndaj rrezeve UV dhe impaktit mekanik, Weberton Pastel përshtatet shumë mirë në të gjitha nënshtresat e qëndrueshme dhe gjen përdorim në muret e jashtme dhe të brendshme

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë
Konsumi	0.25 - 0.35 kg/m² (2 shtresa)

Aplikimi

Weberton Pastel përdoret për mure të jashtme, të brendshme dhe për nënshtresa tashmë të lyera më përpara me bojë dispersive.

Përdorimi

Weberton Pastel duhet të përzihet mirë përpara përdorimit me përzierës elektrik. Të paktën 6 orë para fillimit të punës, nënshtresa duhet të bëhet me astar/bazë weberprim akril dhe nëse aplikohet në nënshtresa të vjetra dhe alkaline, ato duhet të lyhen me astar/bazë weberprim deep para fillimit të punimeve. Pas përzierjes Weberton Pastel hollohet me ujë (10%) pas së cilës aplikohet njëra shtresë dhe pas tharjes së shtresës tjetër. Materiali aplikohet me furçë ose rul, koha e tharjes është 6 orë.

Këshilla

Temperatura e ajrit dhe e nënshtresës për punë dhe tharje mbi 5 ° C dhe nën 30 ° C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të erës, diellit dhe reshjeve - mbrojtja nga dielli dhe era mund të bëhet me një rrjetë mbrojtëse fasade, por është e pamjaftueshme nëse këta faktorë të motit janë të rënduar.

Weberton Silikon

Ngjyrë/bojë silikon me recetë Austriake



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Për restaurimin e sipërfaqeve të vjetra gëlqereje dhe mineraleKundër algave dhe mykutKundërveprim i jashtëzakonshëm me ujë

Përshkrimi

weberton silikon është bojë fasade shumë opake me baza silikon, aditivë dhe mikrofibra rezistente ndaj të gjitha ndikimeve atmosferike, e karakterizuar nga përshkueshmëri e lartë e avujve me koeficient difuzioni të avujve të ujit $\mu = 50$ dhe elasticitet i lartë.



Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.25 - 0.4 kg/m ² (2 shtresa)

Përdorimi

weberton silikon përdoret për të dekoruar muret e jashtme dhe të brendshme, për nënshtresa të veshura me bojë dispersive, sipërfaqe të brendshme të ekspozuara ndaj ngarkesave mekanike (korridore, sallone, kuzhina, banjo).

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe temperatura e sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të kushteve atmosferike. Nënshtresa për të gjitha llojet e bojrave të fasadës duhet të jetë e drejtë, e pastër, solide, pa njolla vaji. Përpara aplikimit, sipërfaqja duhet të jetë trajtuar me astarin/bazën weber.prim S&S, 12h përpara fillimit të punës. Nëse kjo bojë aplikohet në sipërfaqe të vjetra, ato duhet të trajtohen me astarin/bazën weber.prim deep, 6h përpara fillimit të punës. Nëse produkti është i ngjyrosur, Weber rekomandon të përzihet një sasi më e madhe boje në një enë të madhe dhe më pas ta miksosh në mënyrë që përbërësi dhe ngjyra të homogjenizohen dhe të shmangen problemet me nuancat e ngjyrave. weberton silikon përpara përdorimit duhet të miksohet mirë, dhe më pas të hollohet me 5-15% ujë. Produkti aplikohet në dy shtresa.

Weberton ExtraClean

Marmolit me gurë shumëngjyrësh të ngjyrosur artificialisht



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Rezistencë natyrale ndaj mikroorganizmaveKundërveprim i jashtëzakonshëm me ujëPër mirëmbajtjen e fasadës

Përshkrimi

weberton ExtraClean është një bojë/ngjyrë shtresëhollë me aftësi të vazhdueshme vetëpasturese dhe me teknologji elektrostатike në sipërfaqen e saj. Në këtë produkt bashkohen të gjitha cilësitë e mira të silikatit dhe silikonit dhe duke përdorur cilësitë unike, e bën një shtresë finale adapte për të gjithë llojet e fasadave dhe ambienteve që aplikohet. Duke qenë një produkt novator me aftësi vetëpasturese, bën që të reduktohen në maksimum kostot e mirëmbajtjes dhe të zgjasë jetën dhe cilësinë e fasadës. Falë përmbajtjes shumë të vogël të grimcave organike, produkti krijon një ngarkesë elektrostатike dhe pluhuri së bashku me myshqet nuk ngjitet në fasadë. Në të njëjtën kohë fasada është hidrofobike dhe e pastër, duke bërë që në fasadë të ulet efekti i lagështirës dhe të mos krijohet një ambient i përshtatshëm për rritjen e algave apo mikroorganizmave të tjerë.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.25 - 0.4 kg/m ² (2 shtresa)

Përdorimi

weberton ExtraClean përdoret si shtresë finale për përdorim të jashtëm, dekorim dhe mbrojtje të fasadave, me karakteristika termoizoluese. Është i përshtatshëm për përdorim në sistemet termoizoluese dhe mbi bazamente çimentike të paratrajtuar dhe të rrafshuar. Përdoret në ndërtimet e reja si edhe në rindërtimin, modernizimin dhe rinovimin e fasadave të vjetra. I përshtatshëm për përdorim brenda dhe jashtë. Mund të përdoret në vende me ndotje të lartë dhe përmbajtje agresive të ajrit.

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe temperatura e sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të erës, diellit apo shiut. Për mbrojtjen nga dielli dhe era duhet të përdoret një rrjetë skele e vendosur paraprakisht, por kjo nuk është e mjaftueshme nëse kushtet atmosferike janë të rënduara. weberton Extraclean aplikohet me rul ose furçë në sipërfaqen e veshur me astar/bazë më përpara. Weber rekomandon përzierjen e disa kovave në një enë më të madhe për një nuancë uniforme të ngjyrës. Rekomandohet përdorimi i ngjyrave me reflektim të dritës > 30, sepse tonet më të errëta rëndojnë fasadën, përthithin më shumë nxehtësi dhe bëjnë një ndryshim më të madh të temperaturës mes ditës dhe natës. Gjithashtu, pigmentet më të errëta ndikojnë në bojë/ngjyrë duke bërë reaksion kimik dhe rrisin mundësinë e humbjes së tonalitetit të ngjyrave.

PRODUKTET E HIDROIZOLIMIT



Teori Hidroizolimi

Hidroizolimi i ndërtesave është një procedurë e detyrueshme dhe shumë e rëndësishme, Me anë të hidroizolimit, strukturat e ndërtesave mbrohen nga depërtimi i ujit ose humbja e ujit për të shmangur dëmtimet ose vetitë shkatërruese dhe dëmtuese, që krijohen nga moszbatimi i kësaj procedure.

Pse nevojitet hidroizolimi?

Hidroizolimi shmang hyrjen ose humbjen e ujit në strukturat e ndërtimit, shmang ndotjen organike ose kripën, krijon një bazament të shëndetshëm për izolimin termik dhe sistemet e tjera që zbatohen mbi të, luan rol të rëndësishëm në ruajtjen nga shkatërrimi të materialit ndërtimor.

Të gjithë faktorët më sipër ndihmojnë në **Mbrojtjen dhe Jetëgjatësinë** e objektit.

Ku duhet të përdoret hidroizolimi në një objekt?

- Në të gjitha sipërfaqet horizontale të cilat janë të ekspozuara ndaj lagështirës, tarraca, veranda, ballkone
- Në të gjitha zonat me prani lagështire të vazhdueshme si, tualetet, dushet lavanderitë, saunat dhe pishinat dimërore
- Në muret dhe dyshemetë e bodrumeve
- Në pishinat e brendshme dhe të jashtme

Problemet e krijuara nga depërtimi i lagështirës kryesisht janë të kushtueshme dhe Weber i kushton një rëndësi të veçantë ketyre zgjidhjeve. Çdo sipërfaqe, e cila është në kontakt me ujin, duhet të hidroizolohet patjetër për të shmangur të gjitha problemet në lidhje me lagështirën.

PRESIONI POZITIV DHE NEGATIV I UJIT

Si të bëjmë hidroizolim të brendshëm të bodrumeve?



Produktet të listuara sipas rradhës së aplikimit:

- weberprim 813**
- webertec D-Fix**
- webertec 828 DA**
- webertec 828 DB 75**
- Webertherm Adfors**
- Webertec D-Fix**

- Sipërfaqja duhet të jetë e pastër nga pluhurat, lagështia apo njolla vaji që krijojnë vështirësi në ngjitjen e shtresave të hidroizolimit.
- E gjithë sipërfaqja ku do të bëhet hidroizolimi, paratrajtohen me astar/bazë **weberprim 813** për të unifikuar të gjithë sipërfaqen.
- Këndet vertikale dhe horizontale paratrajtohen me shiritat specifike **webertec DB** për hidroizolim, në vendet e bashkimit të mureve me dyshemenë dhe mureve me njëri-tjetrin.
- Po ashtu vendosen dhe këndoret e jashtme dhe të brendshme në vendet përkatëse respektivisht cepat e mureve.

- Më pas aplikohet hidroizoluesi webertec fillimisht në mure dhe më pas në dysheme. Hidroizoluesi aplikohet gjithmonë në dy shtresa – një shtresë e hollë me furçë për të mbushur mirë të gjitha vrimat dhe hapësirat, shtresa e dytë bëhet me mallë metalike duke krijuar shtresën mbrojtëse. Trashësia minimale e hidroizolimit duhet të jetë jo më pak se 3mm.
- Shtresa e hidroizolimit mund të përforcohet me rrjetën **webertherm adfors**, 145gr/m2 me katror 4x4mm.
- Hidroizoluesi duhet të jetë patjetër jo fleksibël dhe i qëndrueshëm për t'i bërë ballë presionit negativ të ujit – **Webertec D-FIX**.
- Dyshemeja aplikohet në fund për të mos shkelur deri në tharjen e plotë të hidroizolimit
- Pas tharjes (1mm trashësi në ditë), aplikohen shtresat e tjera të planifikuara në projekt.

Si të bëjmë hidroizolim të jashtëm të themeleve?



Produktet të listuara sipas rradhës së aplikimit:

- Weberprim 813**
- Webertec Aquaseal 2k**
- Webertherm Adfors 145gr/m2**
- Webertec Aquaseal 2k**
- Webertherm Special W**
- Isover XPS**
- Membranë mbrojtëse me gropëza**

- Sipërfaqja duhet të jetë e pastër nga pluhurat, lagështia apo njolla vaji që krijojnë vështirësi në ngjitjen e shtresave të hidroizolimit.
- Këshillohet një rrafshim apo një përmirësim i sipërfaqes më përpara për të ulur konsumin e hidroizoluesit.
- E gjithë sipërfaqja ku do të bëhet hidroizolimi, paratrajtohen me astar/bazë **weberprim 813** për të unifikuar të gjithë sipërfaqen.
- Këndet vertikale dhe horizontale paratrajtohen me shiritat specifike **webertec DB** për hidroizolim, në vendet e bashkimit të mureve me dyshemenë dhe mureve me njëri-tjetrin.
- Po ashtu vendosen këndoret e jashtme dhe të brendshme në vendet përkatëse, respektivisht cepat e mureve.
- Më pas, aplikohet hidroizoluesi **webertec aquaseal 2K** - fillimisht në mure dhe më pas në dysheme. Hidroizoluesi aplikohet gjithmonë në dy shtresa, të cilat aplikohen me mallë metalike duke krijuar trashësinë e duhur të shtresës mbrojtëse. Trashësia minimale e hidroizolimit duhet të jetë jo më pak se 3mm.
- Shtresa e hidroizolimit mund të përforcohet me rrjetën **webertherm adfors**, 145gr/m2 me katror 4x4mm.
- Duhet dhënë shumë rëndësi rrafshimit sa më të mirë të sipërfaqes duke mos krijuar hapesira apo vrima që lejojnë depërtimin e ujit në themele.
- Pas mbarimit të hidroizolimit, sipërfaqja duhet mbrojtur me shtresë **XPS** ose shtresë polietileni me densitet të lartë, ujëkullues dhe rezistent ndaj agjentëve kimike që gjenden në tokë.

KUJDES!

Hidroizoluesi përzihet vetëm me 2 komponentët e tij. Nuk lejohet të shtohet ujë apo substanca të tjera.

Si të bëjmë hidroizolim të tarracave dhe ballkoneve?



Produktet të listuara sipas rradhës së aplikimit:


1. Isover XPS
2. Shtresë betoni të varfër për pjerrësi dhe zgarë metalike
3. Weberprim 813
4. webertec aquaseal 2k
5. webertherm rrjetë + aksesorë këndorë dhe për fuga
6. webertec aquaseal 2k
7. Shtresë betoni të varfër/Shtresë me pllaka

- Përpara se të bëjmë hidroizolimin, për të shmangur tejnxehjen e tarracës, duhet të termoizolojmë sipërfaqen duke vendosur panelet Isover **XPS** drejtpërdrejt mbi soletën e rrafshuar.
- Më pas, vendosim shtresën e betonit të varfër (ose të lehtësuar) me pjerrësi për të mbrojtur panelet e **XPS** dhe dhënien e pjerrësisë për kullimin e ujërave. Ajo duhet të trajtohet me kujdes me zgarë metalike të përforcuar dhe të krijohen fugat e placës së tarraces, e cila do të lejojë tkurrjen dhe bymimin e të gjithë shtresës, pa krijuar plasaritje.
- Pas mbarimit të kësaj procedure, fillon trajtimi i sipërfaqes së shtresës së betonit të varfër (që ka pjerrësinë e kullimit të ujërave) me astar primer **Weberprim 813**, për të unifikuar të gjithë sipërfaqen nga pluhurat apo njollat e vajit.
- Përforcohen të gjithë cepat vertikale dhe horizontale me **webertec DI/DA** dhe **828** me materialin hidroizolues **webertec aquaseal 2k**.
- Në fugat e lëvizjes vendosen profile Weber me gominë që lejon lëvizjen e pllakave të betonit.
- Shtresa e parë e hidroizolimit **webertec Aquaseal 2K** aplikohet në trashësi 2mm. Më pas, vendoset rrjeta me fibra qelqi **webertherm Adfors** për elasticitet maksimal të shtresës.
- E gjithë sipërfaqja mbulohet me një shtresë të dytë **webertec Aquaseal 2K** duke krijuar në total trashësinë e hidroizolimit 3 – 4 mm.
- Kjo shtresë nuk është shtresë finale dhe nuk duhet lënë në ekspozimin e rrezeve **UV**. Sipër shtresës së hidroizolimit, për mbrojtjen e saj nga rrezatimi **UV** ose ngricat, mund të aplikohet sërish shtresë betoni e varfër ose shtresë me pllaka, sipas detajeve në projekt.
- Aplikimi i këtyre shtresave duhet të respektojë fugat e krjuara në nenshtresën e parë.
- **KUJDES** – Aplikimi i hidroizolimit do të fillojë që në këndin përfundimtar të fasadës duke përfshirë të gjithë lartësinë e parapetit deri në fund të dyshemesë. Në rastin e ballkoneve apo verandave, Weber këshillon të aplikohet hidroizolim në muret e ballkonit deri në lartësinë 90 cm nga dyshemeja.

KUJDES!

Hidroizoluesi përzihet vetëm me 2 komponentët e tij. Nuk lejohe të shtohet ujë apo substanca të tjera.

Si të bëjmë hidroizolim të dyshemesë dhe mureve të tualeteve?



Produktet të listuara sipas rradhës së aplikimit:


1. Shtresë betoni të varfër për pjerrësi
2. Weberprim 813
3. webertec Aquastop 2k
4. webertherm aksesorë
5. webertec Aquastop 2k
6. webercol Gress
7. Shtresë me pllakë gress-porcelain
8. webercolor Comfort

- Në fillim, krijohet shtresa e betonit të varfër me pjerrësi për kullimin e ujërave me drejtim të ujit në pikën e mbledhjes.
- Pasi nënshtresa të jetë e tharë dhe e pastër nga pluhuri apo njollat e vajit, aplikojmë mbi të gjithë sipërfaqen e shtresës së betonit të varfër dhe në mure astarin/bazën primer **Weberprim 813**.
- Aplikohen të gjithë aksesorët këndorë **webertec DB/DI** dhe **828** me hidroizoluesin **webertec aquastop 2K** nëpër këndet horizontale dhe vertikale.
- Aplikohet shtresa e parë e hidroizolimit **webertec Aquastop 2K** me furçë për të mbyllur të gjitha vrimat apo hapësirat ku mund depërtojë uji, në të gjithë sipërfaqet e mureve dhe të dyshemesë.
- E gjithë sipërfaqja mbulohet me një shtresë të dytë **webertec Aquastop 2K** duke krijuar patjetër një shtresë hidroizoluese në total 3 – 4 mm. Kujdes i veçantë tregohet në pjesët e dushit, lavamanit dhe lavatriçes.
- Pasi shtresa të jetë e tharë 1mm në ditë, aplikohen shtresat e tjera sipas projektit.

KUJDES!

Hidroizoluesi përzihet vetëm me 2 komponentët e tij. Nuk lejohe të shtohet ujë apo substanca të tjera.

Si të bëjmë hidroizolim të dyshemesë së pishinave?



Produktet të listuara sipas rradhës së aplikimit:

1. Shtresë betoni të varfër për pjerrësi
2. Shtresë për drejtim me webermur llaç hidrofobik
3. weberprim 813
4. webertec Aquaseal 2k
5. webertherm rrjetë + aksesorë
6. webertec Aquaseal 2k
7. webercol superflex
8. Shtresë me pllakë gress-porcelain
9. Weberepox Easy

- Përgatitja e nënshtresës: produktet e bazës së çimentos janë ideale për këtë aplikim. Betoni i strukturës së pishinës duhet të trajtohet dhe të rrafshohet me makineri gërryerse. Hapat e mëposhtëm duhet të merren parasysh para se të aplikohen shtresat.
- Sipërfaqja duhet të jetë e pastër nga pluhuri, vaji dhe çdo mbetje duke përdorur ujë të pastër. E gjithë nënshtresa duhet të jetë e shëndetshme dhe e pastër.

- Në pishinat e reja të ndërtuara, do të shfaqen vrima që do të shkaktohen nga ngjeshja ose nga deformimi i betonit. Vrima të tilla duhet të pastrohen, të njomen dhe të mbushen me **webermur Ilaç** hidroizolues. Nëse ka ndonjë çarje, ato mund të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në rast të vrimave të mëdha ose betonit të dëmtuar në pishinat e vjetra ose të reja, të gjitha zonat e dëmtuara duhet të gdhenden, pastrohen dhe lagen me ujë të freskët. **Webermur Ilaç** hidroizolues do të aplikohet në një ose dy shtresa në varësi të thellësisë së vrimave.
- Nëse sipërfaqja e betonit është jo e drejtë dhe ndikon në drejtimin e pllakave, sipërfaqja duhet të suvatohet me **webermur Ilaç** hidrofobik për të siguruar që sipërfaqja finale do të jetë e drejtë. Për të patur një shtresë sa më të rrafshët, aplikoni weberplan praktik me fibra dhe përfitoni një sipërfaqe të fortë dhe të rrafshët.
- Edhe dyshemeja prej betoni duhet të rrafshohet duke përdorur shtresën e betonit. Shtresa hidhet në dysheme dhe shpërndahet me mastar çeliku për një trashësi deri në 50 mm ose më tepër, sipas pjerrësisë së kerkuar. Fugat duhet të respektohen në të gjithë sipërfaqen. Për zona të mëdha, fugat duhet të kri-johen çdo 25 m². Shmangni tharjen e shpejtë në rast të temperaturës së nxehtë ose erës.
- Pasi të jeni siguruar që të gjitha hapat e mësipërm janë zbatuar, pishina është gati të marrë shtresën hidroizoluese. Produkti i shkëlqyeshëm me performancë të lartë **webertec aquaseal 2K**, do të përdoret në 3 shtresa:
- Shtresa e parë me trashësi të mjaftueshme 0.5kg/m²: Përdorni një furçë ose një rul. Fiksioni gjerësinë prej 20 cm të rrjetës së fibrave në të gjitha qoshet, fugat dhe çarjet, ndërkohë që shtresa e pjerrësisë së ujit është ende e patharë 100%.
- Pasi të thahet plotësisht, aplikoni shtresën e dytë dhe të tretë në proporcione prej 0.5 - 1 kg/m² me një trashësi të shtresës hidroizoluese prej 5 mm. Rekomandohet të përdoret rrjeta **webertherm Adfors** midis shtresës së dytë dhe të tretë.
- Rekomandohet që para se të fillojë vendosja e pllakave, të bëhet një provë e hidroizolimit dhe pas një jave të fillojë vendosja e pllakave të pishinës.



Weberprim 813



Paketimi:	1L
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none"> Veshje me tharje të shpejtë I lehtë për tu përgatitur dhe aplikuar Për aplikim të sigurtë në ngjitje pllakash ose hidroizolim

Përshkrimi

Bazë/primer universal për trajtimin e bazamenteve përthithëse dhe jo-përthithëse, kryesisht para aplikimit të ngjitësve, hidroizoluesve dhe autonivelantëve.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Shishe
Pesha	1L/shishe
Ngjyra	Terracotta
Konsumi	30 -120 ml/m²

Webertec Superflex 10



Veshje e trashë bituminoze me dy përbërës, e mbushur me polistiren, për hidroizolim të sigurt të ndërtesave

ZONA E APLIKIMIT

FLEKSIBËL

MIQËSORE ME MJEDISIN

Paketimi:	30L
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• Produkt miqësor me mjedisin sepse është pa tretës• Rezistent ndaj ujit që sulmon betonin deri në shkallën “duke sulmuar fuqishëm” sipas DIN 4030• Jashtëzakonisht shumë fleksibël

Përshkrimi

Veshje e trashë bituminoze me dy përbërës, e mbushur me polistiren, për hidroizolim të sigurt të ndërtesave. Për hidroizolim e jashtëm të mureve të bodrumit, pllakave të dyshemesë, themeleve dhe tavaneve të parkimit nëntokësor të makinave në kontakt me tokën. Përveç kësaj, Superflex 10 mund të përdoret nën mallë për mbylljen e ndërmjetme të dhomave të lagura, ballkone ose tarraca që nuk janë të banuara. Produkti mund të përdoret gjithashtu për të lidhur panele shkumë të ngurtë polistireni.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	30kg/kovë
Ngjyra	Zezë
Konsumi	1 - 1,5 l/m²

Udhëzime

Në rastin e ujit me presion betonarmeja duhet të përputhet me DIN EN 206 dhe DIN 1045. Në rastin e rrezatimit diellor duhet të merren masa përkatëse, p.sh. vendosje e pajisjeve që bëjnë hije. Ngjitja nga pllakat mbrojtëse dhe të izolimit si dhe mbushjet e gropëzave duhet të bëhet vetëm pas mpiksjes dhe tharjes së plotë. Për mbrojtjen e sistemit të izolimit rekomandojmë tapetin e drenazhimit/mbrojtës të mbuluar me lesh weber.sys 983. Si rregull, gjatë përpunimit duhet të merret parasysh DIN 18533. Përveç kësaj, duhet të merret parasysh direktiva për projektimin dhe zbatimin e izolimeve me shtresa të trasha bitumi (PMBC) dhe broshurën WTA “izolimi i mëvonshëm i elementëve me kontakt me dheun”. Të gjitha vetitë e dhëna u referohen një temperature + 20°C pa korrent ajri dhe një lagështi relative të ajrit 70%. Gjatë izolimit të konstruksioneve të betonit të hidroizoluara në zonën e fugave të punës dhe fugave të kreut të parafabrikateve prej betoni duhet të merret parasysh direktiva gjermane për konstruksionet e hidroizoluara.

Përgatitja e bazamentit

Bazamenti duhet të jetë pa ngricë, i lirë, i pastër, i thatë sa duhet si dhe pa zift, xhepa dhe plasaritje të hapura si dhe pa ngritje dhe papastërti të tjera. Pjesët përbërëse që u rezistojnë ujit dhe ulin ngjitjen duhet të hiqen, duhet të rrafshohen cepat dhe të rrumbullakosen brazdat. Fugat dhe thellësitë > 5 mm duhet të mbyllen nëpërmjet një shpatulle mbushëse me webertherm prestige.

Webertec Aquaseal 2K



Hidroizolues 2K (25+10) për sipërfaqe të brendshme/jashtme

ZONA E APLIKIMIT

HIDROIZOLIM

TEMPERATURA E LEJUAR
+5°C
+30°C

Paketimi:	25kg + 10kg
Çertifikatat:	EN 14891
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• Hidroizolues me 2 komponente me bazë çimento dhe rezine• Ngjyrë gri• Sipërfaqe vertikale dhe dysHEME

Përshkrimi

Webertec Aquaseal 2K është hidroizolues me 2 komponentë, me bazë çimento dhe i modifikuar me polimerë. Ka në përbërje 25kg pluhur me bazë çimento të përforcuar me aditivë dhe 8kg polimerë të lëngshëm. Përdoret për hidroizolim në ambiente të brendshme dhe të jashtme, mbron bazamentet e betonit, çimentos, tullave dhe blloqeve nga lagështira. Është bazamenti i duhur për instalimin e sigurtë të pllakave në zona të ndikuara vazhdimisht nga uji, si ballkonet, tualetet, dhe kuzhinat.

Përgatitja e bazamentit

Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Bazamentet duhet të jenë të fortë, të thatë, të pastër dhe të niveluar. Në rastet e supeve të vjetra, apo dhe llaçit tradicional, këshillohet që bazamenti të paratrajtohet me astarin e përshtatshëm.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre + bidon
Pesha	25kg/thes + 10kg/bidon
Ngjyra	Gri
Konsumi	2-3 kg/m²

Udhëzime mbi aplikimin

Përmbajtja e thatë e thesit prej 25kg të komponentit (A) duhet të shtohet ngadalë në 10kg e komponentit të lëngshëm (B) duke e përzjerë me mikser elektrik me xhiro të ulta. webertec aquaseal 2K aplikohet në të gjithë sipërfaqen e dëshiruar me furçë ose mallë në minimalisht 2 shtresa. Këndet dhe cepat duhet të mbrohen dhe izoloohen me shiritat hidroizolues webertec 828. Shiritat hidroizolues duhet të vendosen midis 2 shtresave të hidroizoluesit të përgatitur. Aplikimi i secilës shtresë pasardhëse do të bëhet në drejtim pingul me drejtimin e shtresës paraardhëse. Për rezultate të kënaqshme këshillohet që shtresa hidroizoluese duhet të jetë të paktën 2mm – 3mm trashësi. webertec aquaseal 2K nuk është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare, kështu që do të duhet të vishet me shtresën mbrojtëse të përshtatshme.

Webertec Aquastop 2K



Paketimi:	25kg+8kg
Çertifikatat:	EN 14891
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Hidroizolues me 2 komponente me me bazë çimento dhe rezineNgjyrë griSipërfaqe vertikale dhe dysHEME

Përshkrimi

Webertec Aquastop 2K është hidroizolues me 2 komponentë, me bazë çimento dhe i modifikuar me polimerë. Ka në përbërje 25kg pluhur me bazë çimento të përforcuar me aditivë dhe 8kg polimerë të lëngshëm. Përdoret për hidroizolim në ambiente të brendshme dhe të jashtme, mbron bazamentet e betonit, çimentos, tullave dhe blloqeve nga lagështira. Është bazamenti i duhur për instalimin e sigurtë të pllakave në zona të ndikuara vazhdimisht nga uji, si ballkonet, tualetet, dhe kuzhinat.

Përgatitja e bazamentit

Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Bazamentet duhet të jenë të fortë, të thatë, të pastër dhe të niveluar. Në rastet e supeve të vjetra, apo dhe llaçit tradicional, këshillohet që bazamenti të paratrajtohet me astarin e përshtatshëm.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre + bidon
Pesha	25kg/thes + 8kg/bidon
Ngjyra	Gri
Kokërrzimi	0.7 mm
Konsumi	2-3 kg/m²

Udhëzime mbi aplikimin

Përmbajtja e thatë e thesit prej 25kg të komponentit (A) duhet të shtohet ngadalë në 8kg e komponentit të lëngshëm (B) duke e përzjerë me mikser elektrik me xhiro të ulta. webertec aquastop 2K aplikohet në të gjithë sipërfaqen e dëshiruar me furçë ose mallë në minimalisht 2 shtresa. Këndet dhe cepat duhet të mbrohen dhe izolohehen me shiritat hidroizolues webertec 828. Shiritat hidroizolues duhet të vendosen midis 2 shtresave të hidroizoluesit të përgatitur. Aplikimi i secilës shtresë pasardhëse do të bëhet në drejtim pingul me drejtimin e shtresës paraardhëse. Për rezultate të kënaqshme këshillohet që shtresa hidroizoluese duhet të jetë të paktën 2mm – 3mm trashësi. webertec aquastop 2K nuk është i përshtatshëm si shtresë përfundimtare, kështu që do të duhet të vishet me shtresën mbrojtëse të përshtatshme.

Webertec D-fix



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Formimi i një shtrese të qëndrueshme dhe të fortë hidroizolimiRezistent ndaj ndikimit të presionit pozitiv dhe negativ të ujitVeçanërisht rezistente ndaj ndikimeve kimike dhe mekanike

Përshkrimi

Webertec D-fix është një shtresë hidroizoluese dhe kundërvepruese me ujin për të arritur hidroizolim e përbërësve strukturorë të zonës në kontakt me tokën (bodrumi, dhomat e bodrumit dhe pllakat e themelit), rezervuarët e ujit dhe përbërësit e tjerë strukturorë mbi tokë me bazë të çimentos. Webertec D-fix mbron hapësirën nga lagështia e tokës, lagështia kapilare dhe rrjedhja e ujit, si dhe presionet negative dhe pozitive të ujit në sipërfaqet e betonit, çimentos dhe muraturës.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri
Konsumi	2kg/m²

Udhëzime mbi aplikimin

Sipërfaqja ku webertec D-fix aplikohet duhet të jetë e qëndrueshme, e fortë, jo e ngrirë, pa të çara, pa njolla vaji, pa pluhur dhe pa kontaminues të tjerë që pengojnë ngjitjen. Pjesët që bien dhe shpëputen dhe mbetjet e bojës duhet të hiqen me kujdes.Rekomandohet të sheshoni këndet dhe përkuljet me llaç riparues webertherm prestige. Nënshtrësas tepër poroze si betoni apo suvatë me bazë çimento duhet të përmirësohen me ujë të pastër, dhe më pas të pritët të përthithet uji por të lihet nënshtrësja e njomë.

Aplikimi

Gjatë aplikimit, temperatura e ajrit duhet të jetë nga 3°C në +30°C. webertec D-fix përgatitet duke shtuar me kujdes 5.75 litra ujë në produktin 25kg (22- 24% ujë) dhe ta miksosh atë për të arritur një masë të përzier mirë pa toptha të thatë. Përzierja duhet të rrijë për 3-5 minuta dhe më pas të miksohet sërish. Mos shtoni ujë më pas. Përgatitni vetëm sasinë që mund të përdoret brenda 60 minutash.webertec D-fix aplikohet në të paktën 2 shtresa në një interval prej 1 ore. Shtresa aplikohet me mallë ose furçë në një shtresë jo më të trashë se 4mm. Veshja mbrojtëse, pllakat, pllakat e gipsit dhe llaçrat mund të aplikohen vetëm kur hidroizolimi është mjaftueshëm i qëndrueshëm. Mbulesa duhet të ruhet nga impakti direkt i ujit, diellit dhe ngrica për të paktën 24 orë. Mbulesa është tërësisht e thatë pas 72 orësh.

Webertec Smart Protect



Paketimi:	18L
Çertifikatat:	C2TE / S2
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Lidhje e shkëlqyeshme me nënshtresën nën lagështi të lartëZgjidhje jashtëzakonisht fleksibëlI përshtatshëm për të gjitha llojet dhe formatet e pllakave

Përshkrimi

Webertec Smart Protect është një ngjitës shumë fleksibël me 2 komponentë për hidroizolim dhe qeramikë. Zgjidhja inovative përdoret për brenda dhe jashtë, për ngjitjen e të gjitha llojeve të pllakave (qeramike, mermer, granit, gres), si dhe për mbrojtjen e mureve dhe dyshemeve të ekspozuara ndaj veprimit të vazhdueshëm të ujit. Produkti nuk mund të përdoret si material përfundimtar dhe nuk është i qëndrueshëm ndaj rrezeve UV. Për shkak të formulimit të tij të veçantë, rekomandohet që webertec smart protection të përdoret për veshjen dhe mbrojtjen e banjove, kuzhinave, pishinave, tarracave dhe ballkoneve. Produkti aplikohet me një furçë, mistri të sheshtë ose të dhëmbëzuar, në varësi të karakteristikave të nënshtresës dhe qëllimit të produktit. Ai lidhet mirë me pothuajse të gjitha nënshtresët (beton, llaç çimentoje, gur, qeramikë, tulla, sisteme të ngrohjes nën dysheme).

Përgatitja e nënshtresës

Nënshtresa mbi të cilën aplikohet produkti duhet të jetë e pastër, e fortë, e thatë, mbajtëse, pa çarje strukturore dhe pjesë të shkëputshme. Mbetjet e bojrave të vjetra dhe elastike, gëlqeres dhe substancave ekzistuese që reduktojnë ngjitjen (yndyra, pluhuri, veshjet bituminoze etj.) duhet të hiqen plotësisht paraprakisht. Nëse nënshtresa është e ekspozuar ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohen dëmtimet që shkaktojnë shfaqjen e lagështirës, nënshtresa të thahet dhe më pas të punohet. Nënshtresat e betonit (min. 28 ditë të vjetra me lagështi të mbetur ≤2%), dhe llaç me bazë çimento dhe gëlqere (min. 28 ditë me lagështi të mbetur ≤1,5%) llaç gipsi (lagështi e mbetur ≤1%), duhet të ashpërsohet mekanikisht dhe të pastrohet nga pluhuri dhe më pas të lyhet me një astar/bazë. Nënshtresat shumë absorbuese dhe të vjetra duhet të përpunohen me weberprim 813, nga 1 deri në 2 orë para fillimit të punës, në varësi të temperaturës. Nënshtresat nuk duhet të jenë të lagura

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike (thes letre + kanaçe)
Pesha	18l kova plastike (10 kg thesi letrës + 2.8 l kanaçe)+N74
Ngjyra	Gri
Konsumi	1.25 kg/m²/mm për hidroizolim 3 kg/m² për ngjitjen e qeramikës

Mënyra e përdorimit

- Webertec smart protect përgatitet duke shtuar 10 kg përbërës pluhur në 2.8 kg polimer të lëngshëm me përzierje të vazhdueshme. Ndalohet shtimi i ujit dhe/ose aditivëve të tjerë.
- Produkti përzihet me një mikser elektrik derisa të zhduken kokrrat e papërziera.
- Pas përzierjes së parë, prisni rreth 5 minuta që produkti të fryhet në enë dhe më pas përzieni edhe një herë derisa masa të jetë e njëtrajtshme.
- Nënshtresa mbi të cilën aplikohet duhet të jetë e fortë, mbajtëse, e shkrirë dhe e pastër.
- webertec smart protect aplikohet me një mistri të sheshtë ose të dhëmbëzuar (hidroizolues

dhe ngjitës i qeramikës) ose me një mallë (hidroizolues)

- Përdoren përzierjen e përgatitur brenda 30 minutave nga momenti i aplikimit të shtresës së parë.
- Qoshet dhe skajet duhet të sigurohen me shirit dhe këndore hidroizoluese webertec 828, DI dhe DA.
- webertec smart protect aplikohet në një shtresë (duke aplikuar një shtresë hidroizolimi dhe ngjitës qeramike) me trashësi totale deri në 10 mm. Trashësia e veshjes varet nga niveli i nënshtresës, por edhe nga formati i pllakës që do të ngjitet.

- Produkti nuk është një shtresë përfundimtare dhe është e nevojshme të vendoset një shtresë e përshtatshme mbrojtëse mbi të.
- Koha e tharjes së produktit është rreth 24 orë nga momenti i aplikimit (për ngarkesat statike) dhe 48 orë (për ngarkesat mekanike) në varësi të kushteve (temperatura, lagështia, era, etj.).

Weber rekomandon që të bëhen sipërfaqe më të vogla prove përpara fillimit të punës për të kontrolluar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e produktit. Nëse vëreni ndonjë devijim nga cilësia gjatë ndërtimit të sipërfaqes së provës, ju lutemi ndaloni punën dhe kontaktoni një përfaqësues të Saint-Gobain Weber.



Webertec D-protect



Paketimi:	5Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">I përshtatshëm për përdorim të brendshëm dhe të jashtëmMbyll të çarat në kushtet e një ambienti me lagështiShumë elastik dhe kundërveprues me ujin

Përshkrimi

Përgatitet për hidroizolim pa lidhje midis hapësirave të brendshme dhe të jashtme nën pllaka qeramike. Është ideale për hidroizolim në sipërfaqe të mureve dhe dyshemesë, në kushtet e lagështirës në banjo, dushe, kuzhina, tualete publike, si dhe tarraca, ballkone dhe tualete.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	5kg/kovë
Ngjyra	Gri

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5 ° C dhe nën 25°C, i mbrojtur nga impakti direkt i erës, diellit dhe shiut – mbrojtja nga dielli dhe era mund të behët nga një rrjetë skelash, por nuk është e mjaftueshme nëse kushtet e motit janë të rënda. Nënshtrësia ku webertec D-protect përdoret duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër nga njollat e vajit dhe pluhurat. Përpara aplikimit të webertec D-protect, nënshtrësia duhet përgatitur me astarin/bazën weberprim 801. Webertec D-protect aplikohet me furçë, rul ose sprucim në dy shtresa me trashësi totale nga 1 në 1.5mm. Fugat dhe skajet duhet të vishen me shiritin dhe këndet hidroizoluese webertec 828 duke i vendosur në shtresën e parë dhe duke i mbuluar me shtresën e dytë. Shtresa e dy aplikohet pasi thahet shtresa e parë pas 3 orësh. Hidroizolimi është gati 3 orë pas aplikimit të shtresës së dytë.

Performanca

Aftësia për të parandaluar çarjet	0.97 N/mm²
Forca fillestare e lidhjes	≥0.5 MPa
Rezistenca në tërheqje pas cikleve ngrirje-shkrirje	≥0.5 MPa
Rezistenca në tërheqje pas nxehtësisë	≥0.5 MPa
Rezistenca në tërheqje pas zhytjes në ujë	≥0.5 MPa
Pershkueshmeria e ujit	I papërshkueshem

Webertec 828



Paketimi:	10m / 10 copë / 10 copë
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëmElasticitet i lartë dhe rezistent ndaj ujitI përshtatshëm për dhoma të mbushura me ujë

Përshkrimi

Sistemi i veçantë hidroizolues për izolimin e lidhjeve të zgjerimit, këndeve dhe lidhjeve në lidhjet e materialeve të ndryshme, si dhe izolimin e tubacioneve. Shiriti hidroizolues Webertec 828 si dhe këndi i brendshëm dhe i jashtëm përdoren për bashkimin e lidhjeve zgjeruese, përpunimin e këndeve dhe lidhjen në lidhjet e materialeve të ndryshme në mure dhe dysheme. Është gjithashtu i përshtatshëm për izolimin e tubave në dhoma me lagështi. Mund të përdoret për të gjitha klasat e ngarkesës me lagështi A, B, C, AO dhe BO.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Rulon/Copë
Pesha	10m/Rulon 10copë/Kuti
Ngjyra	Bardhë/Verdhë Verdhë





PRODUKTE
PËR SHTRIMIN
E DYSHEMESË

Weberniv Razilit



Autonivelant për dysheme nga 1-3mm

ZONA E APLIKIMIT

KOHA PRITJE PËR TË SHKELUR

TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">I lehtë në aplikimEfikas dhe instalim i shpejtëNënshtresë për shtrimin e parketit, pllakave të qeramikës, tapetet dhe të gjitha llojet e dyshemeve PVC

Përshkrimi

Weberniv Razilit është një përbërës vetë-nivelues i nivelimit të dyshemesë i bërë nga mbushës cilësorë, lidhës të polimerit mineral me cilësi të lartë dhe aditivë të përshtatshëm. Weberniv Razilit përdoret si bazë për shtrimin e parketit, pllakave qeramike, tapetë, si dhe të gjitha llojeve të dyshemeve PVC.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri
Konsumi	1.55 kg/m²/mm

Aplikimi

Nënshtresa duhet të jetë e qendrueshme, e pastër, pa njolla vaji, pa pluhur dhe myshqe. Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Produkti 25 kg miksohet me rreth 7 litra ujë për të bërë një masë të homogjenizuar. Masa duhet të miksohet mirë përpara se të derdhet. Masa e përgatitur derdhet në sipërfaqen e dyshemesë dhe hapet me një mallë në një shtresë 1-3 mm. Masa duhet të përdoret brenda 30 minutave dhe pas shperndarjes në dysheme, duhet të aplikohet me rul me gjemba për nxjerrjen e ajrit nga materiali.



Weberniv Razilit Plus



Llaç vetë-nivelues i përmirësuar për dysheme

ZONA E APLIKIMIT

KOHA PRITJE PËR TË SHKELUR

TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">I lehtë në aplikimNga 3 në 30mm në një shtresëTkurrje jashtëzakonisht e ulët dhe forcë e lartë

Përshkrimi

Weberniv Razilit Plus është një përbërës vetë-nivelues për rrafshimin e sipërfaqeve të brendshme të dyshemesë në një trashësi shtrese prej 3 deri në 30 mm para se të vendosni parket, pllaka,

dysheme PVC, linoleum, qilima dhe mbulesa të tjera të dyshemesë. Weberniv Razilit Plus përdoret për sipërfaqet e brendshme të dyshemesë të bëra nga shtresa betoni dhe çimentoje. Sipërfaqet problematike (pllaka mozaiku dhe qeramike, dysheme druri, shtresa të lëmuara dhe gurë) duhet të përgatiten me një nëmshtresë weberprim 813.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri
Konsumi	1.55 kg/m²/mm

Aplikimi

Nënshtresa duhet të jetë e qendrueshme, e pastër, pa njolla vaji, pa pluhur dhe myshqe. Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5 ° C dhe nën 30 °C. Produkti 25kg duhet të shtohet butësisht në 5 litra ujë. Masa duhet miksuar me shpejtësi të ulët derisa të arrihet homogjeniteti i saj. Pasi të lini produktin e miksuar për 2 minuta, është e nevojshme ta miksoni atë përsëri përpara aplikimit. weber.niv razilit plus aplikohet duke e derdhur mbi nënshtresë. Llaçi do nivelojë vetveten duke u përhapur në bazën e vendit të bashkimit. Masa e tepërt duhet të përhapet në kënde dhe vende të tjera të vështira të nënshtresës duke përdorur furçë apo rul. Pas shtrimit, materiali i shpërndarë në dysheme, duhet të nivelohet me një rul me gjemba për të hequr ajrin nëpër material.



Weberfloor Parketofix

Ngjitës me masë paste për parketet



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">• Për ngjitjen e parketit laminat dhe klasik• Me bazë uji dhe pa aromë

Përshkrimi

Është një masë e parapërgatitur me bazë uji, me acetat polivinili, rezina dhe aditivë. Është një ngjitës parketi, për ngjitjen e parketit klasik dhe laminat, me bazë uji, pa erë (pa toluen).

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë
Konsumi	0.9-1.2 kg/m²

Aplikimi

Nënshtresa duhet të jetë e qendrueshme, e pastër, pa njolla vaji, pa pluhur dhe myshqe. Temperatura e ajrit dhe sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Nënshtresa e betonit duhet të jetë paratrajtuar të paktën 4-6 javë me maksimumi 3% lagështirë, dhe parketi me maksimumi 8-10% lagështirë. weber.floor parketofix aplikohet duke e derdhur në dysheme, përhapur dhe më pas aplikohet dhe shtypet mirë parketi. Lustrimi dhe llakimi vetëm pas 24 orësh.

Tabela e Performancës

Reagimi ndaj zjarrit	Klasa F
Rezistenca në shpëputje pas 72h	4.1 N/mm²
Rezistenca në shpëputje pas 28 ditësh	4.77 N/mm²
Qëndrueshmëria në tërheqje 7 days	1.26 N/mm²
Qëndrueshmëria në tërheqje 28 days	1.18 N/mm²



NGJITËSIT E PLLAKAVE



Standartet për ngjitësat e pllakave dhe bojakët

Ngjitësa për pllaka qeramike. (Kërkesat, përshtatshmëria, klasifikimi dhe marka)

Ky standart është i aplikueshëm për klasifikimin e ngjitësave prej çimentoje për pllaka qeramike për dysheme, veshje të brendshme dhe të jashtme, muret dhe tavanet, si dhe ngjitësave të njomë dhe ngjitësave me bazë rrëshire. Përcakton terminologjinë e ngjitësave për pllaka qeramike, vetitë e aplikimit, performancës, etj. Ky standart nuk siguron kriteret apo rekomandime për projektimin dhe instalimin e pllakave qeramike.

Bojakët, masat për fuga. (Kërkesat, përshtatshmëria, klasifikimi dhe marka)

Ky standart është i zbatueshëm për bojak për pllaka qeramike për mure të brendshme dhe të jashtme, si dhe dysheme. Ky standart për bojakun e pllakave qeramike jep terminologjinë lidhur me produktet, metodat e prodhimit, karakteristikat e aplikimit, etj. Të cilat përcaktojnë më pas kërkesat e performancës për bojaket në përgjithësi, ata me bazë çimento dhe ato me bazë resine.

C	1	Ngjitës i thjeshtë me bazë çimento
C	1F	Ngjitës i thjeshtë me bazë çimento me kohë të shpejtë tharje
C	1T	Ngjitës i thjeshtë me bazë çimento për sipërfaqet vertikale, (më pak rrëshiktje)
C	1FT	Ngjitës i thjeshtë me bazë çimento me kohe të shpejtë tharje për sip. vertikale
C	2	Ngjitës i përmirësuar me bazë çimento
C	2E	Ngjitës i përmirësuar me bazë çimento me kohë pune të zgjatur
C	2F	Ngjitës i përmirësuar me bazë çimento me kohë të shpejtë tharje
C	2T	Ngjitës i përmirësuar me bazë çimento për sipërfaqet vertikale (më pak rrëshiktje)
C	2TE	Ngjitës i përmirësuar me bazë çimento për sipërfaqet vertikale me kohë pune të zgjatur
C	2FT	Ngjitës i permiresuar me baze çimento per siperfaqet vertikale, me kohe te shpejte tharje
D	1	Ngjitës i njomë i thjeshtë
D	1T	Ngjitës i njomë i thjeshtë për sipërfaqet vertikale, (më pak rrëshiktje)
D	2	Ngjitës i njomë i përmirësuar
D	2T	Ngjitës i njomë i përmirësuar për sipërfaqet vertikale, (më pak rrëshiktje)
D	2TE	Ngjitës i njomë i përmirësuar për sipërfaqet vertikale me kohë pune të zgjatur
R	1	Ngjitës i thjeshtë me bazë resine
R	1T	Ngjitës i thjeshtë me bazë resine për sipërfaqet vertikale, (më pak rrëshiktje)
R	2	Ngjitës me bazë resine të përmirësuar
R	2T	Ngjitës me bazë resine të përmirësuar për sipërfaqet vertikale, (më pak rrëshiktje)
C	2-S1	Ngjitës me bazë çimento me fortësi të madhe
C	2-S2	Ngjitës me bazë çimento për deformime të mëdha
CG	1	Bojak i thjeshtë me bazë çimento
CG	2	Bojak i përmirësuar me bazë çimento, me rezistencë të madhe ndaj gërryerjes dhe absorbim të reduktuar të ujit.
RG		Bojak me bazë resine

Zgjidhni atë që u përshtatet - nga ngjitësat e qeramikës

PRODUKTE	webercol smart G	webercol smart W	webercol gress G	webercol gress W	webercol evoflex G	webercol evoflex W	webercol profi
Muret e brendshme							
Mur tulle							
Mur me blloqe							
Shtresa me përbërje çimentoje ose gëlqereje							
Pllakë çimentoje dhe përmbajtje fibroze							
Beton							
Pllaka qeramike							
Sipërfaqe të lyera me bojë							
Suva nivelimi të mureve							
Fino patinimi							
Pllaka gipsi							
Kompensatë							
Dysheme të brendshme							
Anhidrid (sulfat kalciumi) lustër							
Çimento ose rërë e lustruar							
Çimento ose rërë e lustruar (e gjelbër)							
Beton							
Pllaka qeramike ose vinili							
Xham							
Çelik							
Sistem ngrohje-ftohje nën dysheme							
Muret e jashtme							
Mur tulle							
Shtresa me përbërje çimentoje ose gëlqereje							
Pllaka qeramike							
Panele MDF, kompensatë dhe tallashi të presuar							
Dysheme të jashtme							
Çimento ose rërë e lustruar							
Çimento ose rërë e lustruar (e gjelbër)							
Beton							
Pllaka qeramike							
Panele MDF, kompensatë dhe tallashi të presuar							
Përmasa e pllakave / paneleve							
Pllaka me përmasa deri në 10x10cm							
Pllaka me përmasa 20x20cm							
Pllaka me përmasa 30x30cm							
Pllaka me përmasa 40x40cm							
Pllaka me përmasa 60x60cm							
Pllaka me përmasa mbi 60x60cm							
Llojet e pllakave							
Pllaka standarte qeramike							
Pllaka porcelani							
Pllaka xhami							
Tulla							
Pllaka mermeri							
Pllaka graniti							

* Produktet tona nuk aplikohen në sipërfaqe druri

	Vetëm për pllaka qeramike		Pllaka qeramike, porcelani dhe guri natyror		Nuk duhet përdorur!
--	---------------------------	--	---	--	---------------------

Webercol EvoFlex G/W



Paketimi:	25Kg
Çertifikata:	EN 12004
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Ngjitës pllakash i thatë me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griPër mure dhe dysHEME

Përshkrimi

Webercol Evoflex është një ngjitës i parapërgatitur me bazë çimentoje Portland, inertesh të përzgjedhura dhe aditivësh specifikë me fleksibilitet ekstrem. webercol evoflex përdoret në mjedise të brendshme dhe të jashtme për veshjen e bazamenteve të rrafshëta. Përdoret mbi beton, autonivelant dhe llaç tradicional; Gjithashtu mund të aplikohet dhe në sistemet e izolimit termik të jashtëm, në bazament çimentoje. Ky material përdoret për shtrimin e pllakave të qeramikës, gresit, porcelanit, mozaikë të ndryshëm, pllaka mermeri me dimensione të ndryshme dhe pllaka me përthithje të lartë, mbi të gjithë bazamentet. Përdoret në dysHEME dhe mure të brendshme apo të jashtme; në banesa, biznese dhe industri me trafik të lartë; në zona me temperatura shumë të ulëta dhe ngricë. Nuk këshillohet përdorimi në llaçra me bazë gipsi, në materiale plastike, metal dhe dru. Në nënshtresa të lagura dhe në ambjente me prezencë të vazhdueshme të ujit apo lagështire të madhe.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri/Bardhë
Konsumi	0.7 mm

Përgatitja e bazamentit

Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Bazamentet duhet të jenë të fortë, të thatë, të pastër dhe të niveluar. Në rastet e supeve të vjetra, apo dhe llaçit tradicional, këshillohet që bazamenti të paratrajtohet me astarin e përshtatshëm.

Udhëzime mbi aplikimin

Përzierja e produktit me ujë bëhet në një enë të pastër. Përmbajtja e thesit prej 25kg shtohet ngadalë në 6.5 litra ujë dhe përzehet me anë të përzjerësit elektrik me xhiro të ulëta ose mistri, derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Përzierja e përgatitur duhet të pushojë për 5 minuta para se të procedohet me fazën e aplikimit. Masa e përgatitur ripërzehet me anë të një mistrie dhe aplikohet në bazament me një spatul me dhëmbë, në bazë të madhësisë dhe llojit të pllakës. Hapet fillimisht një shtresë e hollë material me anën e drejtë të spatulës, jo vetëm për të eliminuar kështu ndonjë mbetje pluhuri, por gjithashtu për të rregulluar përthithjen e nënshtresës, në mënyrë që të shfrytëzohet më së miri koha e caktuar e hapjes. Pllakat aplikohen duke bërë një lëvizje të lehtë nën presion dhe duke i goditur me kujdes në mënyrë që komplet sipërfaqja të jetë në kontakt me kollën. Lëvizjet e nevojshme të pllakave kryhen 40-50 minuta nga aplikimi. Në raste të formimit të filmit në sipërfaqen e kollës këshillohet të kalohet një shtresë e njomë ngjitësi me spatulën e dhëmbëzuar. Është e këshillueshme që bojaku të aplikohet pas 24-48 orësh.

Tabela e Performancës

Rezistenca në përkulje	≥2,5mm ≤5mm
Rezistenca në tërheqje 28 ditore	≥1 N/mm²
Rezistenca në tërheqje pas cikleve ngrirje-shkrirje	0.8-1 N/mm²
Rezistenca në tërheqje pas nxehtësisë	0.8-1 N/mm²
Rezistenca në tërheqje pas zhytjes në ujë	0.8-1 N/mm²

Webercol Gress G/W



Paketimi:	25Kg
Çertifikata:	EN 12004
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Ngjitës pllakash i thatë me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griPër mure dhe dysHEME

Përshkrimi

Webercol Gress është një ngjitës i parapregatitur me bazë çimentoje, inertesh të përzgjedhura dhe aditivësh specifikë që përmirësojnë ngjitjen dhe punueshmërinë. Përdoret për ngjitjen e pllakave poroze dhe jo poroze të dimensioneve të mesme në mjedise të brendshme dhe të jashtme, në sipërfaqe vertikale dhe horizontale.

Përgatitja e bazamentit

Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Bazamentet duhet të jenë të fortë, të thatë, të pastër dhe të niveluar. Në rastet e supeve të vjetra, apo dhe llaçit tradicional, këshillohet që bazamenti të paratrajtohet me astarin e përshtatshëm.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri/Bardhë
Konsumi	0.7 mm
Konsumi (në ngjitje)	3-5 kg/m²
Konsumi i ujit	7 – 7,5 l
Trashësia min. e shtresës	10 mm

Udhëzime mbi aplikimin

Webermur Stokryl është stuko akrilike për përdorim në bazamentet e betonit ose të kartonxhesit. Rezultati perfundimtar i murit dhe i tavanit do të jetë ekstremisht i bardhë dhe i lëmuar. Përdoret në mjedise të brendshme dhe të jashtme, të thata dhe pa lagështirë.

Përgatitja e bazamentit

Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Bazamenti ku do të aplikohet stuko, duhet të jetë i fortë, i niveluar, i thatë dhe i pastër. Në rast të bazamenteve të vjetra është e këshillueshme që sipërfaqja të paratrajtohet me astarin / bazën e përshtatshme.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes Letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Bardhë
Konsumi	1 Kg/m²
Konsumi i ujit	6.5 - 7 litra
Trashësia min. e shtresës	1,5 - 2 mm

Udhëzime mbi aplikimin

Përzjerja e produktit duhet të bëhet në një enë të pastër. Përmbajtjes së thesit prej 25 kg është e nevojshme t'i shtohet 9-10 litra ujë, duke e përzjerë me përzjerës elektrik, me numër të ulët xhirosh derisa të përfitohet një masë homogjene, pa kokrriza. Koha optimale e përzjerjes nuk duhet t'i kalojë 3 minuta. Masa e përgatitur duhet të aplikohet brenda 1 ore, me anë të mallës metalike në një ose dy shtresa me trashësi maksimale 1,5 - 2 mm secila. Këshillohet që për aplikimin e dorës së dytë të pritët që shtresa e parë të ketë arritur tharjen e nevojshme për të mbajtur peshën e dorës së dytë. Pasi është arritur tharja totale e materialit, nëse është e nevojshme mund të fërkohet sipërfaqja ku është aplikuar materiali me letër zmerile të imët.

Treguesit fiziko-mekanikë

Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	1.100-1.200 Gr/m³
Imtësia mbi sitën me vrima Ø 0.2 m/m	0-2%
Ujë për llaç normal	40-42%
Masa vëllimore e llaçit	1500-1550 Gr/m³
Gjendja	Pluhur

Treguesit kimikë

Lagështira	0.1%
Aditivë	1%

Webermur Polifix T



Stuko patinimi e gatshme për ambiente të brendshme

ZONA E APLIKIMIT

APLIKIM ME MALLË

TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Stuko e gatshmePër riparimin e defekteve, për të mbushur gropat, çarjet dhe vrimat

Përshkrimi

Webermur Polifix T është stuko patinimi e gatshme për ambiente të brendshme. Polifix T është stuko e bardhë e parapërgatitur për rrafshimin e sipërfaqeve të brendshme vertikale dhe të tavanit. Përdoret gjithashtu për të riparuar defektet, për të mbushur gropat, çarjet dhe vrimat.



Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë
Konsumi	1.5 - 2.0 kg/m²

Përdorimi

Nënshtresa mbi të cilën aplikohet weber.mur polifix T duhet të jetë e pastër, e fortë dhe e thatë. Sipërfaqja duhet të jetë e lyer paraprakisht me produkt weberprim podloga. Aplikohet zakonisht në dy shtresa, me dorë, me mistri metalike ose me makineri, në një trashësi totale prej 3 mm. Shtresa e dytë aplikohet pas tharjes së plotë të shtresës së parë dhe pas çdo aplikimi sipërfaqja e trajtuar trajtohet/fërkohet me letër zmerile/gërryese.

Aplikimi

weber.mur polifix T përdoret gjithashtu për riparimin e defekteve, mbushjen e gërvishtjeve, çarjeve dhe vrimave.

Këshilla

Temperatura e ajrit dhe e nënshtresës për punë dhe tharje mbi 5°C dhe nën 30°C.

Webertop Finitura G/W



Fino për
shtresë
përfundimtare



Paketimi:	25Kg
Çertifikata:	EN 998
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Fino dekorative me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griSipërfaqe Vertikale dhe Tavane

Përshkrimi

Webertop Finitura është fino për shtresë përfundimtare me bazë çimento Portland, gëlqerë të hidratuar dhe inerte të përzgjedhura. Produkt premium i pasuruar me fibra për të shmangur plasaritjet dhe lidhjen sa më të mirë me nënshtresen. Përdoret në suvatimet e brendshme dhe të jashtme, mbi të gjitha llojet e sipërfaqeve tradicionale dhe të gjitha bazamenteve përthithëse.

Përgatitja e bazamentit

Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Bazamenti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, i pastër dhe pa prani pluhuri apo mikroorganizmash. Në rastet e bazamenteve të vjetra, apo dhe llaçit tradicional, këshillohet që sipërfaqja të paratrajtohet me astarin / bazën e përshtatshme. Bazamenti duhet të njomet lehtësisht me ujë; në rast të bazamenteve shumë përthithëse apo temperaturave të larta, duhet që

bazamenti të njomet që një natë para aplikimit. Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të rënda të motit.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes Letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri/Bardhë
Konsumi	2,4 - 2,8 kg/m²
Konsumi i ujit	7 - 7.5 litra
Trashësia min. e shtresës	5 mm

Udhëzime mbi aplikimin

Përzjerja e produktit me ujë bëhet në një enë të pastër. Përmbajtja e thesit prej 25 kg përzjehet me anë të përzjerësit elektrik duke i shtuar gradualisht 7-7.5 litra ujë. Koha e përzjerjes nuk duhet t'i kalojë 3 minutat dhe përzjerja duhet të përdoret brenda 2 orësh. Aplikimi kryhet me mallë metalike në një ose dy shtresa, me trashësi maksimale 2 - 2,5 mm secila. Këshillohet që për aplikimin e shtresës së dytë, të pritët që shtresa e parë të ketë arritur tharjen e nevojshme për të mbajtur peshën shtesë. Kur sipërfaqja e materialit arrin tharjen e duhur, mbi të kalohet një bërda sfungjeri të njomë, për të arritur nivelimin përfundimtar të saj.

Treguesit fiziko-mekanikë

Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	1.2-1.3 Gr/m³
Mbjetje 180 µ	45-50%
Uje-mbajtja	97-100%
Masa vëllimore e llaçit në 20°C	1650-1750 kg/l
Gjendja	Pluhur

Treguesit kimikë

Lagështira	0.1%
Aditivë	1.3%



RINOVIMI



Rinovim + përforcim i shtresave të vjetra

Si të rinovojmë një sipërfaqe të vjetër apo të dëmtuar?

- Duke qenë se sipërfaqet dëmtohen si efekt i disa faktorëve, në fillim duhet identifikuar faktori dëmtues, rregulluar/disiplinuar dhe përmirësuar të gjithë detajet që kanë lidhje me këtë faktor.
- Sipërfaqja e vjetër duhet të pastrohet dhe ti hiqen të gjitha pjesët e dobëta duke nxjerrë në pah të gjithë sipërfaqen e qëndrueshme. Më pas sipërfaqja pastrohet nga pluhurat me ujë të bollshëm dhe pas 24 orësh aplikohet astari/bazë e **weberprim deep** - astar me aftësi depërtuese duke bërë përmirësimin e sipërfaqes së vjetër.
- Pas 8 orësh pas aplikimit të astarit, fillojmë aplikimin me produktin **weberplan praktik** i cili bën rrafshimin dhe fortësimin e sipërfaqes duke qenë se në përmbajtje ka fibra akrilike. Për përforcimin e sipërfaqes së aplikuar weber sugjeron përdorimin e rrjetës me fibra qelqi – **webertherm Adfors** për të bërë një sipërfaqe shumë të fortë, fleksibël dhe shumë rezistente ndaj faktorëve të ndryshëm. Pas 24 orësh aplikohet një shtresë e fundit rrafshuese për të arritur një sipërfaqe sa më të drejtë.
- Pas pastrimit të sipërfaqes nga vija e mallës metalike, aplikohet astari/baza e grafiatos para se të bëhet shtresa finale me grafiato minerale apo me grafiato të gatshme të ngjyrosur më përpara me ngjyrat e katalogut Weber.



Weberprim Deep

Bazë /primer me fuqi penetruese



Paketimi:

3 L

Avantazhet:

- Për çdo lloj sipërfaqe problematike fasade
- Penetron thellë në nënshtresë
- Përmirëson kundërveprimin me ujin

Përshkrimi

Bazë/primer për përgatitjen dhe përforcimin e bazamenteve më përthithës. Përdoret për të gjitha llojet e sipërfaqeve problematike të fasadës (minerale, llaç çimentoje dhe gëlqereje, betoni etj). I përshtatshëm për sipërfaqe problematike shumë përthithëse të brendshme që nuk mbajnë mjaftueshëm ngarkesën.

Përgatitja e substratit

Të gjitha nënshtresat mbi të cilat aplikohet duhet të përgatiten paraprakisht: të jenë të thata, të sheshta, të pastra, të ngurta, pa yndyrë, pa pjesë të lirshme. Mbetjet e bojës së vjetër, gëlqeres dhe papastërtive ekzistuese duhet të hiqen plotësisht paraprakisht. Nëse nënshtresa është e ekspozuar

ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohen dëmtimet që shkaktojnë shfaqjen e lagështirës ose të vendoset një shtresë izoluese që do të parandalojë ardhjen e drejtpërdrejtë të lagështirës në shtresën përfundimtare. Nëse ka sipërfaqe me myk, para lyerjes, sigurohuni që t'i shkatërroni ato me dezinfektues. Përpara lyerjes, materialin e sapovendosur duhet ta thajmë të paktën 1 ditë për çdo milimetër të trashësisë së aplikuar.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë
Pesha	3L/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut

Aplikimi

Përdoret për të gjitha llojet e sipërfaqeve problematike të fasadave (llaç mineral, çimento dhe gëlqere, beton ()). I përshtatshëm për sipërfaqe të brendshme problematike shumë absorbuese që nuk janë mjaftueshëm te forta, përpara lyerjes me bojëra dispersioni më cilësore, si dhe para lëmimit me materiale zbutëse.

Mënyra e përdorimit

Para vendosjes së nënshtresës së thellë, weberprim deep përzihet mirë dhe hollohet me ujë në një raport 1:1 me 1:3. weberprim deep aplikohet me një rul me lesh me qime të gjatë, furçë bojë për lyerje me bojëra dispersioni. Kur aplikoni shtresën me rul, rekomandohet përdorimi i një rrjete shtrydhëse. Temperatura e nënshtresës dhe ajrit gjatë aplikimit dhe tharjes së produktit duhet të jetë midis +5° C dhe +35°C, dhe tharja midis dy shtresave për 4-6 orë. Të gjithë parametrat e mësipërm i referohen kushteve standarte të motit: temperatura e ajrit 20°C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që e gjithë procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna dhe të llogaritet në tharje më të shpejtë në mot të ngrohtë ose më ngadalë në mot më të ftohtë. Nëse vëreni një problem gjatë aplikimit, ndaloni punën dhe telefononi një përfaqësues të shitjeve të Weber.

Weberplan Praktik



Llaç nivelues/
rrafshues me fibra
për sipërfaqe të reja
dhe të vjetra

ZONA E APLIKIMIT

TEMPERATURA E LEJUAR

UJË I SHTUAR

Paketimi:	25Kg
Çertifikata:	EN 12004
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Nivelues i thatë me bazë çimentoNgjyrë e bardhë dhe griSipërfaqe të reja dhe të vjetra

Përshkrimi

Weberplan Praktik është rrafshues universal me bazë çimento të bardhë, mbushës cilësorë dhe pasuruar me fibra që përmirësojë performancën. Përdoret për rrafshimin dhe nivelimin e të gjitha sipërfaqeve, të reja dhe të vjetra në restaurim. Përdoret si shtresë përfundimtare dekorative në muret e jashtëm dhe të brendshëm, në të gjitha nënshtresat minerale.

Përgatitja e bazamentit

Bazamenti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë i fortë, i qëndrueshëm, i pastër dhe pa prani pluhuri apo mikroorganizmash. Problemet e mundshme të bazamentit, duhet të riparohen para fillimit të punimeve. Ne rast të aplikimit në bazamente të vjetër, këshillohet që të trajtohen paraprakisht me weberprim podloga IN. Sipërfaqja e punës duhet të jetë e mbrojtur me rrjetë skelash nga impakti i drejtpërdrejtë i erës, diellit apo shiut, këshillohet të mos kryhen punime në kushte të rënda të motit. Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Thes Letre
Pesha	25kg/thes
Ngjyra	Gri/Bardhë
Kokërrzimi	0.7 mm
Konsumi (në arnim)	6-7 kg/m²
Konsumi i ujit	6,5 – 7 litra
Trashësia min. e shtresës	3 mm

Udhëzime mbi aplikimin

Përmbajtja prej 25kg e thesit përziejehet me mikser elektrik duke i shtuar gradualisht 6.5 - 7 l ujë sipas nevojës. Pas përzierjes së parë, masa lihet të prehet për rreth 10 min dhe më pas përziejehet përsëri para se të aplikohet. Përzierja e përgatitur aplikohet mbi bazament me malle në trashesinë e dëshiruar të shtresës, ose sipas nevojës për nivelim të bazamentit. Shtresa përfundimtare dekorative mund të aplikohet 7 ditë pas aplikimit të shtresës së fundit të ngjitësit. Masa e përgatitur duhet të konsumohet brenda jo më shumë se 3 orësh nga përgatitja.

Treguesit fiziko-mekanikë

Masa vëllimore në gjendje të shkrifët	1.40-1.50 Gr/m³
Mbjetje 180 µ	50-60%
Uje-mbajtja	99%
Masa vëllimore e llaçit në 20°C	1780-1880 Kg/L
Pamja	E bardhë
Gjendja	Pluhur

Treguesit kimikë

Lagështira	0.1%
Aditivë	0.5%

Weberton Silikat



ZONA E APLIKIMIT

PËRZIHET PËR PËRDORIMIN

TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Përshkueshmëri e jashtëzakonshme e avujveNgjitje e përhershme me nënshtresënE përshtatshme për rinovime dhe konstruksione të reja

Përshkrimi

weberton silikat është një bojë fasade silikate e cila bazohet në lidhjet e kaliumit me lidhësa akrilikë duke krijuar një bojë shumë rezistente ndaj kushteve atmosferike, e qëndrueshme ndaj dritës, kundërvepruese me ujin dhe përshkueshmëri të lartë të avujve. Koeficienti i difuzionit të avullit të ujit µ = 45.



Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.25 - 0.4 kg/m² (2 shtresa)

Përdorimi

weberton silikat përdoret për mbrojtjen dhe dekorimin e sipërfaqeve të jashtme dhe të brendshme. Nënshtresa në të cilën aplikohet duhet të jetë minerale. Është e përshtatshme për rinovimin e fasadave të vjetra me sipërfaqe minerale dhe instalimin e fasadës minerale në sistemin e izolimit termik.

Aplikimi

Temperatura e ajrit dhe temperatura e sipërfaqes gjatë aplikimit duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të kushteve atmosferike. Nënshtresa për të gjitha llojet e bojrave të fasadës duhet të jetë e drejtë, e pastër, solide, pa njolla vaji. Përpara aplikimit, sipërfaqja duhet të jetë trajtuar me astarin/bazën weber.prim S&S të ngjyrosur, 12h përpara fillimit të punës. Nëse produkti është i ngjyrosur, Weber rekomandon të përzihet një sasi më e madhe boje në një enë të madhe dhe më pas ta miksosh në mënyrë që përbërësi dhe ngjyra të homogjenizohen dhe të mënjanojnë problemet me nuancat e ngjyrës. weberton silikat hollohet me 5% ujë për tonet A & B (sipas ton kartës Weber), 10% për tonet C, D & E (sipas ton kartës Weber), dhe 12-15% nëse boja e fasadës aplikohet në nënshtresa me relief, pavarisht tonit të ngjyrës. Produkti aplikohet në dy shtresa.

Weberpolikolor Dizajn



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Përmirëson rezistencën ndaj gërryerjesMbulim i lartë dhe përshkueshmëri e lartë e avujveMe lidhës organikë

Përshkrimi

Weberpolicolor Design është një bojë cilësore e bazuar në dispersion uji dhe polimerë modernë, rezistente ndaj gërryerjes. Karakterizohet nga rritja e rezistencës ndaj gërryerjes dhe fshirjes në të thatë, si dhe rritje e mbulimit dhe përshkueshmërisë së avullit. Ngjyra është e bardhë, mund të aplikohet në të gjitha nënshtresat e bazuara në gëlqere, çimento dhe gips.

Përgatitja e nënshtresës

Të gjitha nënshtresat mbi të cilat është aplikuar më parë duhet të përgatiten dhe të jenë të thata, të sheshta, të pastra, të ngurta, pa njolla yndyre dhe me përthithje të barabartë, dhe nënshtresat e gropëzuara dhe të dëmtuara duhet të mbushen dhe riparohen paraprakisht. Mbetjet e bojës së vjetër, gëlqeres dhe papastërtive ekzistuese duhet të hiqen plotësisht paraprakisht. Nëse nënshtresa është e ekspozuar ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohen dëmtimet që shkaktojnë shfaqjen e lagështirës ose të vendoset një shtresë izoluese që do të parandalojë ardhjen e drejtpërdrejtë të lagështirës në shtresën përfundimtare. Nëse ka sipërfaqe me myk, para

lyerjes, sigurohuni që t'i shkatërroni dhe ti pastroni me dezinfektues. Përpara lyerjes, stukoja e sapo aplikuar duhet të thatet për të paktën 1 ditë për çdo milimetër të trashësisë së stukos. Para lyerjes së parë, lyeni nënshtresën me një astar të holluar weber (1:8,1 litër bazë dhe 8 litra ujë), mbi 100% të sipërfaqes në të cilën do të aplikohet Dizajni polikolor. Vetë produkti dizajni polikolor i holluar me ujë në një raport 1: 1 mund të përdoret si shtresë bazë. Për sipërfaqe më kërkuese dhe te paqendrueshme, si dhe kur nuk e dini cilësinë e nënshtresës, përpara shtresës së parë të bojës përdorni një astar me penetrim të thellë weberprim primer deep.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.20 kg/m²

Udhëzime mbi aplikimin

Përpara se të aplikoni dizajnin polikolor, përzieni deri në fund dhe, nëse është e nevojshme, holloni me ujë maksimumi 20% për shtresën e parë dhe maksimumi 10% për shtresën e dytë. Weber rekomandon të bëni sipërfaqe më të vogla provë përpara se të filloni punën për të kontrolluar nuancën e produktit. Nëse vëreni ndonjë devijim nga cilësia kur bëni sipërfaqen e provës, ju lutemi ndaloni punën dhe kontaktoni një përfaqësues të shitjeve të Weber. Polikolor Design aplikohet me furçë, lesh me fije të gjata ose rul boje tekstili ose spërkatje në dy shtresa. Është e nevojshme të aplikohet vazhdimisht dhe pa ndërprerje, për të shmangur pabarazitë që ndodhin për shkak të bashkimit të sipërfaqeve dhe tharjes së pabarabartë të produktit. Temperatura e nënshtresës dhe e ajrit gjatë aplikimit dhe tharjes së produktit duhet të jetë ndërmjet 5 dhe 35°C, dhe tharja ndërmjet dy shtresave për 4-6 orë. Të gjithë parametrat e mësipërm i referohen kushteve standarte të motit: temperatura 20°C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që e gjithë procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna dhe të llogaritet në tharje më të shpejtë në mot të ngrohtë ose më ngadalë në mot më të ftohtë. Nëse vëreni një problem gjatë aplikimit, ndaloni aplikimin dhe telefononi një përfaqësues të shitjeve të Weber.

Weberpolikolor Eko



Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">E thjeshtë dhe e lehtë për t'u aplikuarBardhësi e shkëlqyerPërshkueshmëri e lartë e avullit

Përshkrimi

Weberpolikolor Eko është një bojë për ambiente të brendshme. Produkti karakterizohet nga përshkueshmëri e lartë e avujve dhe bardhësi e shkëlqyer. Polikolor Eko është e përshtatshme për lyerjen e të gjitha nënshtresave të thata dhe të forta, sipërfaqet vertikale dhe tavanet me suvatim të imët, sipërfaqet me fibra çimentoje, beton dhe pllakat e gipsit.

Përgatitja e nënshtresës

Të gjitha nënshtresat mbi të cilat është aplikuar më parë duhet të përgatiten: të thata, të sheshta, të pastra, solide, po njolla vaji dhe me perthithje të barabartë, dhe nënshtresat e gropëzuara dhe të dëmtuara duhet të mbushen dhe riparohen paraprakisht. Mbetjet e bojës së vjetër, gëlqeres dhe papastërtive ekzistuese duhet të hiqen plotësisht paraprakisht. Nëse nënshtresa është e ekspozuar ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohen dëmtimet që shkaktojnë shfaqjen e lagështirës ose të vendoset një shtresë izoluese

që do të parandalojë ardhjen e drejtpërdrejtë të lagështirës në shtresën përfundimtare. Nëse ka sipërfaqe me myk, para lyerjes, sigurohuni që t'i shkatërroni dhe pastroni me dezinfektues. Përpara lyerjes, materiali i sapo aplikuar duhet të thatet për të paktën 1 ditë për çdo milimetër të trashësisë se aplikuar. Para lyerjes së parë, lyeni nënshtresën me astar të holluar weberprim (1: 8, 1 litër primer dhe 8 litra ujë), mbi 100% të sipërfaqes në të cilën do të aplikohet polikolori EKO. Boja weberpolikolor EKO e holluar me ujë në raport 1:1 mund të përdoret si shtresë bazë. Për sipërfaqe më kërkuese dhe te paqendrueshme, si dhe kur nuk e dini cilësinë e nënshtresës, përpara shtresës së parë përdorni një astar me penetrim të thellë weberprim deep.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.19 kg/m²

Udhëzime mbi aplikimin

Para aplikimit, polikolori EKO përzihet deri në fund dhe, nëse është e nevojshme, hollohet me ujë jo më shumë se 20% për dorën e parë dhe jo më shumë se 10% për dorën e dytë. Weber rekomandon të bëni sipërfaqe më të vogla provë përpara se të filloni punën për të kontrolluar nuancën e produktit. Nëse vëreni ndonjë devijim nga cilësia kur bëni sipërfaqen e provës, ju lutemi ndaloni punën dhe kontaktoni një përfaqësues të shitjeve të Weber. Polikolor EKO aplikohet me furçë, lesh me qime të gjatë ose rul ose sprucim për bojë tekstili në dy shtresa. Është e nevojshme të aplikohet vazhdimisht dhe pa ndërprerje, për të shmangur pabarazitë që ndodhin për shkak të bashkimit të sipërfaqeve dhe tharjes së pabarabartë të produktit. Temperatura e nënshtresës dhe e ajrit gjatë aplikimit dhe tharjes së produktit duhet të jetë ndërmjet 5 dhe 35°C, dhe tharja ndërmjet dy shtresave për 4-6 orë. Të gjithë parametrat e mësipërm i referohen kushteve standarde të motit: temperatura 20 ° C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që e gjithë procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna dhe të llogaritet në tharje më të shpejtë në mot të ngrohtë ose më ngadalë në mot më të ftohtë. Nëse vëreni një problem gjatë funksionimit, ndaloni funksionimin dhe telefononi një përfaqësues të shitjeve të Weber.

Weberpolikolor Gold



ZONA E APLIKIMIT

APLIKIM ME RUL

+5°C
TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Bojë me mbulim të jashtëzakonshëmResistente ndaj fshirjes me material të lagurRezistencë e shkëlqyer ndaj gërryerjes

Përshkrimi

Weberpolikolor Gold është një bojë dekorative e cilësisë së lartë për mure të brendshme me bazë akrilati. Karakterizohet nga mbulim i lartë dhe rezistencë ndaj fshirjes me material të lagur dhe me bardhësi të theksuar. Polikolor Gold mund të aplikohet në nënshtresat e gëlqeres, çimentos, betonit, bojrave të vjetra minerale dhe sintetike. Mund të aplikohet edhe në pllaka gipsi.

Përgatitja dhe përdorimi

Nënshtresa në të cilën aplikohet para fillimit të punimeve duhet të jetë aplikuar weberprim podloga. Boja duhet përzier mirë para përdorimit dhe më pas, duke i shtuar 20-30% ujë me përzierje, deri në homogjenizimin e plotë. Nëse produkti është i ngjyrosur, Weber rekomandon që sasi më të mëdha të bojës të përzihen në një enë më të madhe në mënyrë që të bëhet unifikimi i tonalitetit të ngjyrës. Produkti aplikohet me rul ose furçë në dy shtresa. Shtresa e dytë aplikohet pas 3-4 orësh duke i lënë kohë për t’u tharë shtresës së parë.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.20 kg/m²

Këshilla

Temperatura e ajrit dhe e nënshtresës për punë dhe tharje mbi 5°C dhe nën 30°C, pa ndikim të drejtpërdrejtë të faktorëve të motit. Nuk rekomandohet aplikimi i weberpolikolor gold në nënshtresa të vjetra, veçanërisht nëse ka lagështi në mure. Për të parandaluar shfaqjen e hijeve, nuk rekomandohet aplikimi i tij në mure të sapo suvatuara, të pathara mirë (1mm/ditë) dhe në prani të drejtpërdrejtë të lagështirës.

Shënim

Të gjithë këta parametra i referohen kushteve standarde të motit - temperatura 20C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuara është në përputhje me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit të bojrave të brendshme. Kompania nuk mban përgjegjësi për kryerjen jo te rregullt të punës me materialin e specifikuar, për përdorimin e materialeve për qëllime që nuk specifikohen në përshkrimin e produktit, si dhe për kryerjen e punës në kushte moti që nuk janë në përputhje me përshkrimin e specifikuar të produktit. Weber rekomandon që sipërfaqet e provës të bëhen përpara fillimit të punës. Kompania pranon ankesa vetëm për cilësinë e produktit, nëse ai ruhet, përgatitet dhe zbatohet sipas udhëzimeve të nxjerra

Weberpolikolor Latex



ZONA E APLIKIMIT

APLIKIM ME RUL

+5°C
TEMPERATURA E LEJUAR

Paketimi:	25Kg
Avantazhet:	<ul style="list-style-type: none">Rezistente ndaj larjes dhe dezinfektuesvePër zona me higjienë të shtuar

Përshkrimi

Weberpolicolor Latex është një bojë shumë rezistente ndaj larjes dhe ndaj fshirjes me dezinfektues. Është menduar për lyerjen e mureve të brendshme në ndërtesat rezidenciale dhe tregtare, shkollat, kopshtet, qendrat shëndetësore, spitalet, banjat, hotelet, kuzhinat. Policolor Latex përdoret për të gjitha ambientet ku kërkohet një nivel i shtuar i higjienës, i cili arrihet me larjen e shpeshtë të sipërfaqeve të lyera me agjentë pastrimi universal. Për të gjitha sipërfaqet që janë patinuar dhe lëmuar me produkte që përmirësojnë rrafshimin dhe imtësimin e sipërfaqes finale si pllakë gipsi, çimentoje, beton të pasuvatuar etj.

Përgatitja e nënshtresës

Të gjitha nënshtresat mbi të cilat aplikohet duhet të përgatiten paraprakisht dhe duhet të jenë të thata, të sheshta, të pastra, të ngurta, pa yndyrë dhe po aq absorbuese, dhe nënshtresat e pabarabarta dhe të dëmtuara duhet të mbushen paraprakisht dhe të riparohen me shtresa cilësore si webermur glet ose webermur Stuko. Mbetjet e bojës së vjetër, gëlqeres dhe papastërtive ekzistuese duhet të hiqen plotësisht paraprakisht. Nëse nënshtresa është e ekspozuar ndaj lagështirës, është e nevojshme që fillimisht të riparohen dëmtimet që shkaktojnë shfaqjen e lagështirës ose të vendoset një shtresë izoluese që do të parandalojë ardhjen e drejtpërdrejtë të lagështirës

në shtresën përfundimtare. Nëse ka sipërfaqe të infektuara me myk, para lyerjes, sigurohuni që t’i pastroni me dezinfektues. Përpara lyerjes, duhet të thajmë patinimin të sapo instaluar për të paktën 1 ditë për çdo milimetër të trashësisë së aplikuar. Para patinimit dhe fërkimit me letër gërryese, lyeni nënshtresën me një astar/bazë të holluar weberprim podloga (1: 8, 1 litër bazë dhe 8 litra ujë), mbi 100% të sipërfaqes në të cilën do të aplikohet polikolor latex. Vetë boja, weberpolikolor latex i holluar me ujë në një raport 1: 1, mund të përdoret si shtresë bazë (astar/bazë). Për sipërfaqe më të veshтира dhe me cilësi më të ulët, si dhe kur nuk e njihni cilësinë e nënshtresës, përpara shtresës së parë përdorni një astar me penetrim të thellë weberprim primer deep.

Informacion Teknik

Lloji i paketimit	Kovë plastike
Pesha	25kg/kovë
Ngjyra	Bardhë/Sipas Katalogut
Konsumi	0.15-1.19 l/m²

Udhëzime mbi aplikimin

Para aplikimit, polikolor latex përzihet mire dhe, nëse është e nevojshme, hollohet me ujë jo më shumë se 5%. Weber rekomandon të bëni sipërfaqe më të vogla provë përpara se të filloni punën për të kontrolluar hijen e produktit. Para se të aplikojmë bojën në sipërfaqe më të mëdha, për të cilat na duhen më shumë kova, Weber sugjeron që të gjithë sasinë e bojës ta përziejmë në një enë të madhe për të unifikuar tonalitetin e ngjyrës. Ngjyra e bardhë nuk ka nevojë të perzihet. Polikolor latex aplikohet në dy shtresa me një rul me qime të gjatë (gjatësia e fibrave 18-20 mm), me penel dhe furçë për lyerje për bojëra me dispersion. Kur lyeni me rul, rekomandohet përdorimi i një rrjete shtrydhëse. Është e nevojshme të aplikohet vazhdimisht dhe pa ndërprerje në të gjithë sipërfaqen e murit për të shmangur tonalitetet e ndryshme të shkaktuara nga bashkimi i sipërfaqeve dhe tharja e njëtrajtshme e produktit. Temperatura e nënshtresës dhe ajrit gjatë aplikimit dhe tharjes së produktit duhet të jetë midis +5°C dhe +35°C, dhe tharja midis dy shtresave për 4-6 orë. Të gjithë parametrat e mësipërm i referohen kushteve standarte të motit: temperatura e ajrit 20°C, lagështia relative deri në 65%. Nëse kushtet e motit nuk janë në përputhje me sa më sipër, është e nevojshme që e gjithë procedura e punës të përshtatet me rrethanat e dhëna dhe të llogaritet në tharje më të shpejtë në mot të ngrohtë ose më ngadalë në mot më të ftohtë. Nëse vëreni një problem gjatë aplikimit, ndaloni punën dhe telefononi një përfaqësues të shitjeve të Weber.

INOVACIONI





Fasadë ndriçuese? Bojakë që shndërrin natën?

Me inovacionin e Weber kjo nuk është një ëndërr por një realitet

Si rezultat i një kërkimi prej më shumë se 7 vitesh, ne jemi këtu tju prezantojmë gamën tonë të produkteve **Weber NEON**. Sipërfaqet e veshura me suvatë dhe bojakët tona në ngjyra të ndryshme të natës përthithin dritën e diellit dhe e emetojnë energjinë e përthithur në formën e ndriçimit në errësirë duke krijuar një efekt rrezatues. Produktet inovative të Saint-Gobain janë fosforeshente; kështu, pas iluminimit, ato e lëshojnë energjinë e ruajtur për orë të tëra. Për më tepër, produktet do vazhdojnë të rrezatojnë edhe pasi efekti fosforeshencës të ketë mbaruar, duke lëshuar ndriçim të bardhë, madje gjithë natën! Na bashkohuni në botën ndriçuese të **NEON!**




Bojë fasade ndriçuese

Një surprizë mahnitëse kur nata bie! Me bojën tonë ndriçuese, ju mund të krijoni dizajne mbresëlënëse, të pa para më parë, sekret i së cilës zbulohet vetëm në errësirë!



- Ndriçim Neon
- Vetë veshëse e shkëlqyer
- Rezistente ndaj ujit
- Rezistente ndaj kushteve klimaterike





Suva ndriçuese

Nga sot, ju nuk keni pse t'i thoni mirë u pafshim ngjyrave kur bie nata! Suvaja weberpas NEON ndriçon në errësirë, kështu zgjidhjet me dizajn unik nuk do të kufizohen më nga errësira, por vetëm nga imagjinata juaj!



- Ndriçim Neon
- Pa alga dhe i pandotur
- Me teknologjinë AquaBalance®
- Cilësi Premium
- Përshkueshmëri e shkëlqyer e avujve



Bojakë ndriçuese


High-quality grout with reduced water absorption and high wear resistance. Available in two basic colours and three types of neonizing effects.



- Ndriçim Neon
- Fleksibël
- Rezistente ndaj ujit
- Teksturë më kremoze
- E lehtë dhe e shpejtë për tu aplikuar
- Mund të përdoret për ngrohje nën dysheme
- Klasifikim sipas MSZ EN 13888: CG2AW



weber.design
—househousehouse—



weber.design Brick



FASADË DEKORATIVE, IMITIM TULLE

- zgjidhje unike për fasadën
- e lehtë në përgatitje dhe aplikim
- pa nevojën e muraturave të rënda
- mundësi të pafundme kombinimi të suvasë
- dekorative dhe astarit/bazës së ngjyrosur

Nuancat e suvasë dekorative



Brick 01



Brick 03



Brick 05

Hapat e aplikimit



Aplikohet astari/baza



Mbështet shablloni



Ngjeshet me kujdes në bazë



Aplikohet suvaja dekorative



Krijohet relievi sipas dëshirës



Hiqet shablloni

Performanca

weber.design BRICK është fasadë dekorative, imitim tulle, e cila përfitohet nga kombinimi i tre produkteve:

- **weber.design BRICK** – suva dekorative me lidhësa silikon
- **weber.design primer** – astar/bazë i/e ngjyrosur
- **weber.design BRICK matrix** – shabllon me strukturën e tullës

weber.design BRICK përdoret për dekorimin dhe mbrojtjen e fasadës duke ruajtur të gjitha avantazhet e sistemit të izolimit termik të jashtëm.

Tashmë është e mbundur të përfitohet struktura e rregullt e fasadës së tullës pa patur nevojë të ndërtohen mure të dyfishta, të përgatitet llaç murature apo të shpenzohet kohë dhe energji.

weber.design BRICK vesh estetikisht, në mënyre unike fasadën, duke ofruar mundësi të pafundme kombinimi midis suvasë dekorative dhe astarit/bazës së ngjyrosur.

Përgatitja dhe mënyra e aplikimit

Temperatura optimale e nënshtresës dhe ajrit gjatë aplikimit duhet të variojë midis +5°C dhe +25°C, pa ndikimin direkt të diellit apo shiut. Këshillohet që një ditë para aplikimit të suvasë dekorative, e gjithë sipërfaqja të trajtohet me astarin/bazën weber.design primer – të ngjyrosur sipas kartës së ngjyrave Weber. Astari/baza aplikohet me furçe ose rul me lëvizje horizontale e më pas me lëvizje vertikale, në të gjithë sipërfaqen e fasadës. Shablloni i strukturës së tullës vendoset në shtresën e thatë të astarit/bazës duke e ngjeshur lehtësisht në sipërfaqe.

Para aplikimit në fasadë, suvaja dekorative e ngjyrosur duhet të përziejhet mirë. Për të përfituar nuancë uniforme të ngjyrës, Weber këshillon që të përziejehen disa kova njëheresh. Aplikimi i shtresës së suvasë dekorative bëhet me anë të mallës së çelikut në trashësi rreth 5mm.

Për të përfituar kombinime shumë ngjyrëshe të tullës, mund të përdoren dy ose më shumë nuanca në suvanë dekorative, secila duhet të aplikohet me rradhë, njëra pas tjetrës. Shablloni duhet të hiqet menjëherë pas aplikimit të suvasë dekorative, ndërkohë që kjo e fundit është ende e njomë.

weber.design Stone



FASADË DEKORATIVE, IMITIM GURI

- Zgjidhje unike për fasadën
- e lehtë në përgatitje dhe aplikim
- pa nevojën e punimeve të rënda
- pa nevojën e materialeve të shtrenjta natyrore
- mundësi të pafundme kombinimi të suvasë
- dekorative dhe astarit/bazës së ngjyrosur

Nuancat e suvasë dekorative



Sandstone



Granit 01

Hapat e aplikimit



Aplikohet astari/baza



Mbështet shablloni



Ngjeshet me kujdes në bazë



Aplikohet suvaja dekorative



Krijohet relievi sipas dëshirës



Hiqet shablloni

Performanca

weber.design STONE është fasadë dekorative, imitim guri natyror, e cila përfitohet nga kombinimi i tre produkteve:

- **weber.pas marmolit** – suva dekorative akrile me gurë shumëngjyrësh
- **weber.design primer** – astar/bazë i/e ngjyrosur
- **weber.design STONE matrix** – shabllon me strukturën e gurit

weber.design STONE përdoret për dekorimin dhe mbrojtjen e fasadës duke ruajtur të gjitha avantazhet e sistemit të izolimit termik të jashtëm.

Duke kombinuar ngjyrat e ndryshme të suvasë dekorative dhe astarit/bazës së ngjyrosur është e mundur të përfitohet pamja natyrale e fasadës së gurit, pa patur nevojë të ndërtohen mure të rënda apo të shpenzohet kohë dhe energji për trajtimin e materialeve natyrore.

weber.design STONE vesh estetikisht, në mënyre unike fasadën, duke ofruar mundësi të shumta kombinimi midis varianteve të suvasë dekorative dhe astarit/bazës së ngjyrosur.

Përgatitja dhe mënyra e aplikimit

Temperatura optimale e nënshtresës dhe ajrit gjatë aplikimit duhet të variojë midis +5°C dhe +25°C, pa ndikimin direkt të diellit apo shiut. Këshillohet që një ditë para aplikimit të suvasë dekorative, e gjithë sipërfaqja të trajtohet me astarin/bazën weber.design primer – të ngjyrosur sipas kartës së ngjyrave Weber. Astari/baza aplikohet me furçe ose rul me lëvizje horizontale e më pas me lëvizje vertikale, në të gjithë sipërfaqen e fasadës. Shablloni i strukturës së gurit vendoset në shtresën e thatë të astarit/bazës duke e ngjeshur lehtësisht në sipërfaqe.

Para aplikimit në fasadë, suvaja dekorative weber.pas marmolit duhet të përziejhet mirë. Për të përfituar nuancë uniforme të ngjyrës, Weber këshillon që të përziejehen disa kova njëheresh. Aplikimi i shtresës së suvasë dekorative bëhet me anë të mallës së çelikut në trashësinë e kokrrizës më të madhe, rreth 2.5mm.

Shablloni duhet të hiqet menjëherë pas aplikimit të suvasë dekorative, ndërkohë që kjo e fundit është ende e njomë.

weber.design Wood




FASADË DEKORATIVE, IMITIM DRURI


- Zgjidhje unike për fasadën
- e lehtë në përgatitje dhe aplikim
- pamje natyrale
- mundësi të shumta kombinimi të suvasë dekorative

Nuancat e suvasë dekorative	
	Tik
	Arrë
	Qersh
	Lis
	Pishë


Hapat e aplikimit




Aplikohet suvaja dekorative




Sipërfaqja rrafshohet me letër




Aplikohet shtresa e dytë e suvasë dekorative




Kalohet vegla e posacme për të dhënë strukturën




Sipërfaqja e tharë gërryhet lehtësisht



Aplikoni bojën e posaçme të fasadës



Boja e tepërt pastrohet me një sfungjer të njomë



Pamja përfundimtare ndikohet nga forca dhe shpeshtësia e lëvizjeve

Performanca

weber.design WOOD është zgjidhje e avancuar fasade dekorative e cila thekson bukurinë e drurit natyral, duke e imituar në sipërfaqen e fasadës. Pamja përfundimtare e strukturës së drurit përfitohet nga kombinimi i tre produkteve:

- weber.design WOOD** – suva mbushëse
- weber.design primer** – astar/bazë
- weber.design WOOD bojë fasade** – 5 nuanca të drurit natyral
- weber.design WOOD tool** - vegël për strukturën e drurit

weber.design WOOD përdoret për dekorimin dhe mbrojtjen e fasadës duke ruajtur të gjitha avantazhet e sistemit të izolimit termik të jashtëm.

weber.design WOOD bojë fasade është e disponueshme ne pesë nuanca natyrale të drurit: pishë, lis, qersh, arrë dhe tik.

Zgjidhja e plotë **weber.design WOOD** rezulton në një fasadë moderne e cila me kalimin e kohës nuk ka nevojë për mbrojtje dhe rivitalizim, për të përfituar strukturën estetike dhe duke mënjeluar kështu të gjitha dobësitë e drurit natyral.

Përgatitja dhe mënyra e aplikimit

Temperatura optimale e nënshtresës dhe ajrit gjatë aplikimit duhet të variojë midis **+5°C** dhe **+25°C**, pa ndikimin direkt të diellit apo shiut. Këshillohet që një ditë para aplikimit të suvasë dekorative, e gjithë sipërfaqja të trajtohet me astarin/bazën **weber.design**. Astar/baza aplikohet me furçe ose rul me lëvizje horizontale e më pas me lëvizje vertikale, në të gjithë sipërfaqen e fasadës. Pasi astari/baza të jetë tharë, me mallë çeliku aplikohet shtresa e parë e suvasë mbushëse **weber.design WOOD** në trashësi shtrese 1mm.

Pasi shtresa e parë e suvasë të jetë tharë, sipërfaqja kalohet me letër zmerile për të eliminuar parregullsitë, e më pas aplikohet një shtresë e dytë suvaje mbushëse në trashësi maksimale 2mm. Shtresa e dytë aplikohet me spatul të dhembëzuar gjithmonë në të njejtin drejtim, në mënyrë që të krijohet struktura e viteve të drurit. Struktura përfundimtare, e cila do të varjojë nga gjerësia e dhembëzimit, jepet me anë të veglës së posaçme dhe mund të ketë nevojë për një trajtim të lehtë me letër zmerile para veshjes me bojë. Para se të aplikohet boja e fasadës, këshillohet që sipërfaqja e strukturuar të pastrohet nga pluhuri apo mbetjet me furçe të thatë.



weber.design WOOD boja e fasadës aplikohet me furçe ose rul mbi sipërfaqe dhe ndërkohë që është ende e njomë kalohet me një sfyngjer të lagur për të dhënë efekt sa më real.

weber.design Beton



FASADË DEKORATIVE, IMITIM BETONI

- Zgjidhje unike për fasadën
- Imitim perfekt dhe pa mirëmbajtje
- Pa ura termike

Nuancat e suvasë dekorative	
	odetenek 1962C
	odetenek 1962D

Hapat e aplikimit















Performanca

weber.design BETON është fasadë dekorative, imitim betoni, i cili përfitohet nga kombinimi i tre produkteve:

- NPU 700/705 weber.design primer** – astar/bazë për veshje përfundimtare
- weber.pas** – suva dekorative, kokërrzim 1.5mm + astarin standart të përshtatshëm
- W92 weber.design BETON** – smasë niveluese për fasada imitim betoni

Produkti përdoret për dekorimin dhe mbrojtjen e sistemit të fasadës. Gjithashtu përdoret për të imituar sipërfaqet moderne të betonit duke ruajtur njëkohësisht të gjitha avantazhet e sistemit termik të jashtëm.

weberdesign BETON vesh estetikisht, në mënyrë unike fasadën, duke ofruar mundësi kombinimi midis suvasë dekorative dhe astarit/bazës së ngjyrosur dhe duke minimizuar kostot e mirëmbajtjes.

Përgatitja dhe mënyra e aplikimit

Temperatura optimale e nënshtresës dhe ajrit gjatë aplikimit duhet të variojë midis **+5°C** dhe **+25°C**, pa ndikimin direkt të diellit apo shiut. Rekomandohet që nënshtresa të jetë me bazë çimentike ose me suva dekorative me kokërrzim 1.5mm. Përpara aplikimit të suvasë që do shërbejë si nënshtresë, e gjithë sipërfaqja duhet të paratrajtohet me astarin e përshtatshëm në varësi të suvasë dekorative që do përdoret. Nënshtresa duhet të jetë e sheshtë, e thatë, pa njolla vaji, solide dhe e pastër nga mbetjet dhe jo e deformuar nga tkurrjet apo çarjet. Përpara aplikimit të fasadës, të gjitha mbetjet e mëparshme duhet të pastrohen. Aplikoni astarin me lëvizje horizontale e më pas me lëvizje vertikale në të gjithë sipërfaqen e fasadës për të arritur një përhapje optimale mbi sipërfaqe. Nqs bazamenti nuk është çimentik, suvaja dekorative **Weber.pas** e ngjyrosur sipas betonit, aplikohet pasi astari është tharë. Trashësia e shtresës duhet të jetë 1.5mm sa kokërrzimi i suvasë.

Astari **NPU 700/705 weber.design** aplikohet në nënshtresë me një furçe ose rul në të gjithë sipërfaqen. Astari duhet të aplikohet një ditë përpara shtresës përfundimtare. Masa niveluese **weber.design BETON** duhet të aplikohet në të gjithë sipërfaqen duke përdorur një mallë metalike. Lëreni të thahet dhe aplikoni një shtresë tjetër në mënyrë të barabartë ose pabarabartë që të përfitohet pamja e betonit. Me një kalim të dytë të mallës në sipërfaqe në mënyrë gjatësore riprodhohet struktura e betonit. Pas kohës së përshtatshme të tharjes, e cila varion nga temperatura dhe lagështira në ajër, sipërfaqja fshihet me leckë për të përfituar pamjen finale të imitimit të betonit. **Weber** rekomandon të përdoren ngjyrat e ndezura tek vijëzimet - indeksi i reflektimit të dritës (HBW) duhet të jetë mbi 25.



Sokol Osmani
Product & Marketing Manager
Sokol.Osmani@saint-gobain.com
+355 69 204 4500

Sales Contact
sales.albania@saint-gobain.al



Departamenti i Marketingut
Rr. Budull, Nr. 3, 1039 Ahmetaq, Prezë
Vorë - Shqipëri
www.saint-gobain.al